

LEXMARK
LEGAL

Nese ju duhet një avokat
mos hezitoni te na kontaktoni



Adresa: Ashley House 235-239 High Road
Wood Green, London, N22 8HF
Tel:0208 090 2488 info@lexmarklegal.com



Tel:07435119343
Tel:07494181220
Tel:07379691924




The Albanian

VITI I 20 I BOTIMIT 10 NENTOR 2024

Tel: 020 7018 7929 30 Avenons Road London E13 8HT

A DO TË TAKOHET RAMA ME
'ÇUNAT E LAMANSHIT'?



PETRIT KUÇANA

**ÇDO TË BËHET
ME MIJËRA
SHQIPTARË ILEGAL
NË BRITANI?**



ARBEN MANAJ

**ALEANCA E PËRJETSHME
ÇFARË DO NDOHË
MES TRUMP DHE
QEVERISË SË MAJTË
NË ANGLI?**


**A DO TA HANË VERIORËT
E DIASPORËS
'PAKETËN E MALEVE'
TË RAMËS?**

ALFRED LELA



**RAMA – MARANGOZ I ZOTI I
SKENAVE KOMIKE,
AKTOR I DOBËT NË SKENËN
NDËRKOMBËTARE**

EMIN AZEMI



**BOTA E
DONALD TRUMP**

BEN BLUSHI



**BURGU,
E VETMJA RRUGË...**

LUTFI DERVISHI



**PYETJE PËR PARTITË:
SI DO TË
NDIZET POÇI?**

VETON SURROI



**POROSISNI BANNERIN
PËR BIZNESIN TUAJ**

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dotech
website




The Albanian newspaper in London

www.thealbanian.co.uk

THE ALBANIAN
www.thealbanian.co.uk

albania7@gmail.com

Tel: 020 7018 7929



PETRIT KUÇANA

Është paralajmëruar që Edi Rama do të mbajë një fjalim në Londër pikërisht me 24 nëntor. Vazhdohet e njëjta skenaografi dhe zhargoni "krenar me Shqipërinë" do të jetë sfondi i një paradoksi të tmerrshëm. Mijëra shqiptarë çdo ditë braktisin atë vend të begatë, dhe kryeministri vjen e kërkon votën e të larguarve?!

Të vetëdijshëm se Londra 'është e vështirë', për shkak të shumë specifikave, po bëhet gjithçka që fjalimi të jetë siç e kërkon ai, duke krijuar imazhin se shqiptarët e Britanisë (aq sa mund të jenë, e duan Ramën).

Të paktën dy herë ka ardhur zv-kryeministrja Balluku për t'u siguruar se çdo gjë po shkon mirë, pas shtyrjes së fjalimit të parë të anuluar muaj më parë.

Nuk mund të mungonte edhe ministri Balla, dhe nënkuptohet angazhimi i çdo qelize të shtetit shqiptar, për të mbledhur shqiptarë që fjalimi i Ramës të mos dalë jashtë parashikimeve.

Të gjithë e dijnë se Londra për shkak të shumë specifikave është e vështirë për të plotpërbushur skenarin gati-gati tallava, ku kombi dhe atdheu përcudnohen tmerrsisht keqas, por që pesha e rëndësës duhet të bijë mbi fjalët e përzgjedhura të Ramës e theksi logjik kurrësesi mbi arsyen, shkakun, mbi pse-në, por mbi çfare tha dhe se si duartroktjet nuk do të mungojnë në arenën e madhe që do të transmetohet drejtpërsëdrejti nga masmedia shqiptare.

Pra kryeministri po vjen për të folur për Shqipërinë krenare, në

një vend, kur të paktën dy shqiptarë i dhanë fund jetës së tyre në kampet britanike për të mos u kthyer në atë Shqipërinë e lavdishme të Ramës. Rama do të flasë për krenarinë shqiptare në një vend, ku me mijëra shqiptarë janë në kushtet e mbijetesës, pra shqip pa letra, dhe vazhdojnë të mbijetojnë pasi nuk kanë ku kthehen, ku vazhdimisht po vijnë shqiptarë të tjerë edhe me varka... ku ekuilibri i jetë-vdekjes është tejet i brishtë, ku nuk janë të pakta rastet e jetëve të humbura në Lamansh.

Duhet theksuar se kurrë, as edhe njëherë të vetme Rama në këto 12 vite nuk është ndalur në Londër që të 'takohet me emigrantët' qofshin këta edhe simpatizantët të tij. Hera e fundit që mbahet mend është kur ka qenë lider i opozitës.

Dhe ja tani ka vendosur që të dalë e të kërkojë votën e diasporës në mënyrën e tij, një mënyrë aspak britanike, me mitingje e fjalimë, por duket se është e vetmja mënyrë për t'i shpëtuar themelit të demokracisë për shtete normale; llogaridhënies.

Jo Rama nuk dëshiron të japë llogari, qoftë edhe sa i kushton ky fjalim taksapaguesve shqiptarë, ku nga një kërkim i thjeshtë në internet dalin mijëra e mijëra paundë vetëm salla.

Çfarë mund t'u thoshte zoti Rama famijarëve të atyre që i dhanë fund jetës dhe se shteti i Ramës nuk iu gjend pranë dhe se u detyruan të kërkojnë ndihmë nga qytetarët për të kthyer arkemortin në mëmëdhe?!

Kostot janë sa një drekë e rëndomtë e Ramës në Londër. Llogaridhënia?

Deri më sot nuk është bërë e ditur sa kanë kushtuar fjalimet e Ramës në Athinë, Selanik apo Milano. Pse?

A është gjëja më normale e mund-



shme që kryeministri Rama të deklarojë shpenzimet, kryeministri i një prej vendeve më të varfëra të Evropës?

Imagjinoni për një moment sikur media shqiptare të mos transmetojë asgjë nga Rama derisa ai të bëjë transparencën e fondeve?

Kushedi sa e pabesueshme u duket shumëkujt kjo aksiomë tejet normale.

**Pse nuk i bën publike shpenzimet Rama?
Nga se ka frikë?
Çfarë e shqetëson?**

Po sikur ato fjalime Rama t'i inçizonte me specifikat përkatëse dhe t'i transmetonte në rrjetet sociale, sa para do të kurseheshin? Sa energji e çdo qelize shtetërore që janë duke punuar për këtë fjalim? Çfarë do të ndodhte që Rama të bënte takime, (pra jo fjaime) me grupe të ndryshme shqiptarësh të këtushme dhe përveç llogaridhënies të adresonte problematikat e tyre?

Kryeministri Rama duhet të japë llogari së pari se pse që në marrjen e detyrës rreth 12 vite më parë Rama përjashtoi regjistrimin

e makinave angleze. Sot e kësaj dite asnjë shqiptar nuk mund të regjistrojë makinat me targa angleze (vetëm mund t'i përdorin deri në 6 muaj) që duket tejet absurde edhe për patronazhistët më të thekur... e deri tek marrëveshje me Britaninë për kthimin e shqiptarëve.

**Sa shqiptarë janë kthyer nga Britania si pasojë e kësaj marrëveshje?
Çfarë është bërë me ta?**

**Sa prej tyre janë asistuar nga institucionet e shtetit shqiptar?
Asnjë i vetëm?
Qoftë edhe ata që nuk kanë lekë të shkojnë në familjet e tyre nga aeroporti?**

**Si është e mundur që asnjë nga biznesmenët e Diasporës nuk është aq me fat që të shpallet investitor strategjik?
Pse?**

Si është e mundur që diaspora vazhdon të konsiderohet si mërgatë qyqesh që vazhdojnë të mbajnë ekuilibrimin social në Shqipëri?

Imagjinoni për një moment nëse diaspora nuk do të dër-

gonte asnjë qindarkë çfarë do të ndodhte në Shqipëri.

Si ka mundësi që kryeministri nuk i hodhi njëherë sytë nga të 'shkolluarit' në Britani aseti më i çmuar për çdo komb?

Apo duhet të jenë me patjetër patronazhistë se përndryshe i prishin shumë punë propagandës qeveritare?

Për t'u kthyer tek pyetja themelore;

Çdo të bëhet me mijëra e mijëra shqiptarë që nuk kanë letra në Britani?

Sa është numri i shqiptarëve që kanë ardhur në Britani në këto 12 vite dhe sa përgjegjës e ndien veten kryeministri që vjen të mbajë fjalim, kur nuk e ka përllogaritur dhe nuk do e përllogarisë kurrë minimumin jetik edhe sikur 12 vite të tjera të rrijë në pushtet? Pra Rama vjen për fjalim në Londër dhe kurrësesi si llogaridhënës siç do të duhej të ndodhte nga një kryeministër normal.

A mund të quhet kryeministri i gomoneve?

**L E X M A R K
L E G A L**

Ashley House 235-239 High Road
Wood Green, London, N22 8HF



**07435119343
07494181220
07379691924**

**NESE JU DUHET NJË
AVOKAT MOS HEZITONI
TE NA KONTAKTONI**

Individual & Family Visas

- Asylum and Human Rights
- Family and Spouse visa
- European visas
- Student or tier 4 visa
- Visitor visa
- Indefinite leave to remain
- British citizenship

Appeals & Administrator Review

- Immigration Appeals and Review
- Immigration Detention,
- Bail and Removal



Për më shumë informacione në lidhje me procedurat ligjore,
ju lutem kontaktoni ekspertët tanë ligjorë të cilët do t'ju ofrojnë
çdo konsultë ligjore të domosdoshme

Tel: 0208 090 2488 info@lexmarklegal.com

 Discover The Latest Trends in Technology

Dotech
website 

“ **AKOMA NUK KENI
NJË WEBSITE PËR
BIZNESIN TUAJ?** ”

Akoma nuk jeni regjistruar në Google?

Adresa e zyrave:

30 Avenons Road London E13 8HT



Dotech
website 

Për çdo konsultim mund të na kontaktoni
ose mund të vini në zyrat tona

- BUSINESS CARDS
- LOGO
- BANNERS
- POSTERS
- VIDEO MARKETING



Tel: 020 7018 7929



Mob: 073 4066 5946



Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road London E13 8HT

MY **UK**
Law

AVOKATI JUAJ
SHQIPTAR
I LICENCUAR NGA SRA

MY **UK**
Visas

Ne jemi të specializuar në:
Çështje emigracioni
Çështje familjare dhe divorci
Pronësi
Neglizhencë
Gjoha dhe dënime rrugore



Arta Heath

Avokate dhe Partnere Menaxhuese

Na kontaktoni nga e Hëna në të Premte, nga ora 9:00 - 17:30



Huddersfield

Besmir Mujo

+44 (0) 7861 391147



Sheffield

Klodiana Gjonaj

+44 (0) 7454 819683



London

Daniel Buna

+44 (0) 7832 599757



Tirana

Dorotea Celaj

+355 69 659 8957

Për linjën jashtë orarit, kontaktoni +44 (0) 7931 327665 çdo ditë jave pas orës 17:30 deri në 20:30 dhe ditën e shtunë nga ora 09:00 deri në 12:00.



reviewsolicitors
TRUSTED LAW FIRM



"EXCELLENT"

4.8 / 5 STARS | 152 REVIEWS



Ranked
TOP 10%

2024



Solicitors
Regulation
Authority

ARBEN MANAJ

Që kur ish-udhëheqësi legjendar britanik i Luftës së Dytë Botërore, Uinston Curcill, përdori togfjalëshsin " marrëdhëniet speciale" mes ish- Perandorisë britanike dhe Shteteve të Bashkuara, shpesh është ngritur që prej atëhere pikëpyetja për të ardhmen e këtyre marrëdhënieve unike, sa herë ka pasur kuaj karroce të racave të ndryshme ideologjike në Shtëpinë e Bardhë dhe Doëning Street.

Aq më shumë në këtë rikthim të Trump që përballë do ketë si homolog një Kryeministër të qëndrës së majtë, si Sir Keir Stamer.

Si ky I fundit ashtu edhe Ministri i Jashtëm aktual, në të shkuarën jo të afërt kanë pasur prononcime të forta ndaj politikanit Trump, të cilat ata shpresojnë të jenë haruar. Pragmatizmi politik i ka detyruar, sic ndodh shpesh në politiken e madhe të kapërdijne

atë që kanë thënë, dhe të punojnë për interesa më të mëdha.

Që gjatë fushatës ata kanë kontaktuar me ekipin e Trump, madje kanë qënë në shtator për dy orë për darkë në Kullën Trump me presidentin e ri dhe sipas burimeve diplomatike, darka ka kaluar shumë mirë. Minisitri i Jashtëm David Lammy shpreson tek marrëdhëniet me zv-presidentin e ri JD Vance me të cilin kanë raporte të hershme që nga koha kur të dy mendonin shume negativisht për Trumpin.

Enigma mbesin krizat e mëdha dhe luftrat, por diplomatët britanike shpresojnë në dashurinë e Trampit për bërje ujdërash, që ai ti bëj presion Putinit dhe mos e braktis Ukrainën.

ALEANCA E PËRJETSHME/ ÇFARË DO NDODHË MES TRUMP DHE QEVERISË SË MAJTË NË ANGLI?



Por ajo ku Britania mbetet disi e papergatitur është tek luftrat

tregtare dhe kërcënimin e tarifave 10 për qind të mallrave të importuara në Amerikë, edhe pse

ka një lloj qetësie se marrëdhëniet tregëtare mes Britanise dhe SHBA-se, janë më shumë të karakterit të shërbimeve, të cilat mund të mos preken nga këto tarifa. ndërkohë Britania eksporton mallra me një vlerë prej 70 miliardësh , në makina, produktet farmaceutike dhe uiskin skocez, c'ka është sa dyfishi i volumit tregëtar me Gjermaninë.

Edhe pse turbulencat ekonomike dhe globale gjithmonë shoqërohen me kosto, qeveria e Sir Keir Stamer, shpreson se kane bere sa kanë mundur te ofrojnë një sistem kapot për ti mbajtur te ngrohta marrëdhëniet mes dy anëve të Atlantikut, cka pritet të konfirmohet gjate 4 viteve të ardhshme



NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

**POROSISNI
BANNERIN PER
BIZNESIN TUAJ**

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



Emigracion dhe Prona

- Aplikacione per visa bashkshortore, si te fejuar dhe visa turistike
- Heqja e Nenshtetsis Britanike
- Ankesat gjyqsore, Ndalimi pa letra ne Kampe Emigracioni dhe Urdhra Deportimi
- Aplikime per Viza Studenti dhe Viza Pune
- Aplikime per Viza ne Baza te Drejtave te Njeriut nga brenda Britanis
- Ceshtje Azii dhe Skllaveri Moderne

- Shitje dhe Blerje te Pronave
- Rihipoteka dhe Financimi i Pronave
- Dhenie me Qira te pronave Komercale
- Zgjatje dhe Rinovime te Kontratave te Pronave Komercale

Sigurojeni te ardhmen tuaj sot me keshillen e duhur profesionale ligjore!



Po Kerkoni Per Ndhime Juridike Nga Ekspert Legal?

Per me shume informacion:

Kontaktoni Partner dhe Avokate:

Oliverta Mediu

Phone: 020 7063 9040

Mobile: 079 4603 5736

Email: o.mediu@wslegal.co.uk

Address: 2nd Floor 2-5 Minories,
EC3N 1BJ

NJË VEPËR E VLEFSHME PËR PROCESIN E KRIJIMIT TË SHTETIT SHQIPTAR DHE PËR ROLIN E SHQIPTARËVE NË RËNIEN E PERANDORISË OSMANE

Recension për librin e fundit të Daut Dautit, botuar nga shtëpia e njohur botuese, Bloomsbury Academic

NGA: ANDREW THOMAS PARK, STUDIUES DHE PROFESOR NË UNIVERSITETIN E HONG-KONGUT / REVISTA JOURNAL OF BRITISH STUDIES (2024), 1-2, BOTUAR NGA CAMBRIDGE UNIVERSITY PRESS. PËRKTHEU: AGRON SHALA

Libri i Daut Dautit, Britania dhe çështja shqiptare gjatë rënies së Perandorisë Osmane, 1876-1914 [Britain, the Albanian Question and the Fall of the Ottoman Empire, 1876-1914], gjurmon marrëdhëniet dhe perceptimet e ndërsjella midis elitës politike britanike dhe lëvizjes së sapolindur nacionaliste shqiptare, gjatë katër dekadave që çuan në krijimin e shtetit shqiptar. Nëse për pjesën më të madhe të kësaj periudhe këto marrëdhënie ishin kryesisht të heshtura, për një moment të shkurtër – por, vendimtar, gjatë Konferencës së Ambasadorëve në Londër më 1912-'13 – Britania luajti një rol vendimtar. Libri i Dautit ofron një sfond të dobishëm për këto zhvillime, duke u thelluar më herët në kohë sesa studimet e tjera në gjuhën angleze mbi krijimin e shtetit shqiptar dhe duke përdorur burime në gjuhën shqipe dhe nga arkivat ish-osmane.

Në libër, Dauti ndjek kryesisht një strukturë kronologjike. Pavarësisht periudhës së përmendur në titull, kapitulli i parë fillon në fund të shekullit të tetëmbëdhjetë me përshkrimet e para për Shqipërinë të botuara në Britani – kryesisht nga shkrimtarë udhëpërshkrues, ku më i njohuri ishte poeti Lord Bajron [Byron]. Një tjetër shkrimtar interesant që udhëtoi në rajon ishte Benjamin Disraeli, i cili e vizitoi Shqipërinë në vitin 1830, pak pas rimarrjes së kontrollit në vend nga osmanët, duke masakruar qindra krerë shqiptarë që kishin mbështetur grekët në kryengritjen e tyre të mëparshme.

Përshkrimi pozitiv i shqiptarëve nga Bajroni dhe Disraeli bazohej në pikëpamjet e tyre laike, një perspektivë që kundërshtohej nga liberalizmi kristiano-centrik i William Gladstoneit. Qëndrimet britanike ndaj Shqipërisë, argumenton libri, u skalitën kryesisht nga pozicionet konservatore dhe liberale që përfaqësonin Disraeli dhe Gladstone. Megjithatë, kjo nuk solli ndryshime të prekshme në rezultatet politike për shqiptarët.

Kapitulli 2 e ilustron këtë duke vënë në dukje se, pavarësisht qëndrimit të përzemërt të Disraelit gjatë Kongresit të Berlinit më 1878 dhe më pas – sekretari i tij i Jashtëm, Lord Salisbury, u takua me një delegacion të Lidhjes Shqiptare, të trupit të parë (jetëshkurtër) të organizuar të unitetit politik shqiptar – ai në fund “nuk iu përgjigj kërkesës së tyre” (37). Konservatorët i shihnin shqiptarët si një mburojë mbështetëse të Perandorisë Osmane, ndërsa, për të njëjtën arsye, liberalët i shihnin ata si myslimanë të padenjë për mbështetjen



Daut Dauti

BRITAIN, THE ALBANIAN QUESTION AND THE FALL OF THE OTTOMAN EMPIRE, 1876-1914

BLOOMSBURY

që ata ua jepnin popullsisë të krishtera të Perandorisë Osmane. Kapitulli 3 shqyrton këto perceptime konkurruese teksa vepronin brenda Komitetit Ballkanik – një grup presioni për politikën e jashtme, i themeluar më 1903 dhe që mbështeste autonominë e Maqedonisë Osmane, por që kryesisht e shihte rajonin “përmes prizmit të fesë” dhe për këtë arsye prirëj të anashkalonte rolin e shqiptarëve (56).

Shqipëria ishte, sigurisht, gjithmonë pjesë integrale e çështjes maqedonase dhe e fatit më të gjerë të Perandorisë Osmane në Evropë. Kapitujt 4-6 e përshkruajnë këtë dhe kështu nxjerrin në pah edhe rolin e Britanisë në lëvizjen kombëtare shqiptare. Shoqëria Britanike dhe e Huaj Biblike luajti një rol të rëndësishëm që nga mesi i shekullit të nëntëmbëdhjetë në përkthimin dhe shpërndarjen e Dhiatës së Re në gjuhën shqipe, e cila, siç shkruan Dauti, ishte “popullore thjesht sepse

ishte një libër në shqip” (88). Britania luajti gjithashtu një rol në planet politike të politikanëve kryengritës shqiptarë. Kur ishte ende besnik ndaj osmanëve dhe jo ende themelues i Shqipërisë moderne, Ismail Bej Qemali i dërgoi sulltanit një memorandum në vitin 1892, duke kërkuar një federatë ballkanike dhe një antantë me Britaninë për të zbrapsur Rusinë.

Në fund, pas Revolucionit të Xhonturqve të vitit 1908, të cilin Dauti e riformulon mirë në lidhje me rolin e rëndësishëm të luajtur nga Shqipëria, qeveria osmane do të orientonte veten drejt Gjermanisë. Ai vëren se si politika e gjuhës shpejt prishi mbështetjen e mëparshme të shqiptarëve me xhonturqit, gjë që përfundimisht çoi në armiqësi të hapur dhe pasoja më të gjera.

Megjithatë, çështja e gjuhës ndihet gjithashtu në një mënyrë tjetër. Ndërsa shkrimi i Dautit është kryesisht i qartë, ka disa idiosinkrazi,

zgjidhja e të cilave mund të kishte ndihmuar lexuesin.

Ndërsa kryengritja shqiptare e vitit 1911 dështoi, ajo arriti të nxiste Britaninë të mbështeste autonominë shqiptare, gjë që Dauti e përshkruan si “një hap vendimtar në braktisjen, nga qeveria britanike, të politikës miqësore ndaj Portës” (106). Kryengritësit shqiptarë patën më shumë sukses në vitin 1912, por mundësia e autonomisë shqiptare shqetësoi shtetet fqinje ballkanike dhe kjo kontribuoi në shpërthimin e Luftërave Ballkanike. Lindja e Shqipërisë gjatë Konferencës së Ambasadorëve në vitet 1912-'13, u ndihmua nga Sir Edward Grey, i cili tani e shihte më së miri shërbimin ndaj interesit britanik duke avokuar për një shtet të ri.

Diskutimi i Dautit mbi këtë diplomaci është disi i përmbledhur dhe është më mirë i shpjeguar në librin Lindja e Shqipërisë [The Birth of Albania, 2012] nga Nicola Guy dhe në studimin klasik të Ernst Helmreichut të vitit 1938. Po ashtu, argumenti si i tërë mund të kishte përfituar nga një angazhim më i thellë në kontekstin më të gjerë ndërkombëtar, i cili ndonjëherë humbet për shkak të përqendrimit të ngushtë të Britanisë. Megjithatë, libri i Dautit nuk është një histori e ngushtë diplomatike, por një përpjekje për të ilustruar lidhjen midis perceptimeve të brendshme britanike dhe rezultateve politike.

Kapitujt 7 dhe 8, dy të fundit të librit, pasqyrojnë këtë, pasi shqyrtojnë karrierat e dy mbështetësve të shquar britanikë të çështjes shqiptare, të cilët ndihmuan në formësimin e opinionit publik gjatë kësaj periudhe. Edith Durham dhe Aubrey Herbert ishin të dy anëtarë të pakënaqur të Komitetit të Ballkanit, të cilët u zemëruan nga injorimi i çështjes shqiptare nga ky komitet. Herberti krijoi Komitetin Shqiptar për ta kundërshtuar këtë qëndrim, por ndikimi përfundimtar i përpjekjeve të tij publike është i vështirë për t'u gjykuar. Komiteti kritikoi rezultatin e Konferencës së Londrës, por vetë Herberti lavdëroi Greyn.

Duket se Durhami pati më shumë sukses duke ndikuar te diplomatët britanikë – nga terreni në Ballkan. Megjithatë, pasi u largua nga Shqipëria në vitin 1914, ajo u kthye vetëm një herë, shtatë vjet më vonë – dhe mbeti e zhgënjyer, duke shkruar, siç e citon Dauti: “[Nuk] ndjej se Shqipëria ime ekzistonte më” (134). A mund të kishte ekzistuar vërtet ndonjëherë Shqipëria e imagjinuar nga ndonjëri prej britanikëve që trajtohen në këtë libër?

Cilado qoftë përgjigjja për këtë pyetje, në eksplorimin e perceptimeve të brendshme britanike, Dauti ofron një sfond të vlefshëm për procesin e krijimit të shtetit shqiptar, i cili përfundimisht u realizua. Në këtë mënyrë, Dauti gjithashtu arrin të rikthejë rëndësinë e Shqipërisë në historinë e rënies dhe shpërbërjes së Perandorisë Osmane. /Telegrafi/

QUALITY

BUDGET FRIENDLY CLINIC

HEALTHCARE

- Same day Appointment
- Well-Being + Gender Scans (16 Week)
- Weight Loss Injections
- Hearth Check-Up
- Health Check-Up
- Botox & Filler & Skin Booster & PRP
- Hair - Loss Mesotherapy Injection

Need a trusted North London GP? Medplus Clinic offers private, convenient healthcare that fits your busy life.

Book appointment via phone or online, choose your time, and enjoy same-day appointments at our easily accessible location near Silver Street Station, Angel Corner-Edmonton. Quality care, in and out in under 30 minutes. Visit Medplus Clinic today!



Medical Services

- GP Consultation
- Paediatric Consultation
- Cardiology Consultation
- Dermatology Consultation
- Gynaecology and Obstetrics Consultation with Ultrasound
- Psychiatry
- Check-Up
- Ear, Nose, Throat (ENT) Consultation
- Ultrasound Scan
- Counselling & Psychotherapy
- Skin Examination
- Injection (without medication)
- Ear Wax Removal
- Psychology



Aesthetic Services

- Migraine Botox
- Masseter Botox
- Underarm (Armpit) Botox
- Filler for Cheeks
- Filler for Nasolabial Folds
- Filler for Marionette Lines
- Chin Filler
- Lip Filler
- Jawline Contouring with Filler
- Non-Surgical Rhinoplasty
- PRP (Platelet-Rich Plasma) Therapy
- Skin Rejuvenation
- Mesotherapy
- Skin Boosters
- Dermapen
- IV Vitamin Drip
- Glutathione Treatment
- IM Vitamin Injections
- Fat-Dissolving Injections
- Hair-Loss Mesotherapy Injections



CHOOSE US FOR :

- Specialized Expertise
- Diagnostic Services
- Vaccinations
- Holistic Care
- Check Up



MORE INFORMATION

02082927485

07440014118

www.medplus.org.uk

175 Fore Street
Edmonton London
N18 2XB

Monday - Saturday 9 AM - 6 PM

10% OFF

Stay Connected, Save More with Medplus Clinic! Get £20 OFF just for following us on Facebook or Instagram, and enjoy 10% OFF all treatments at Medplus Clinic.

Follow us for exclusive savings on quality care in North London. Book now!

Follow Us: medplusclinic medplusclinic



MedPlus Clinic

Silverstreet Station

Angel Corner

Car Parking

ALFRED LELA

Në 23 kilometra dhe mbi 9 orë ecje në malet dhe fshatrat e Pukës, në segmentin Iballë-Berishë, kam ndeshur gjithsej 5 njerëz. Njëri ishte i marri i Papit, një fshat me tri shtëpi ende të banuara. Përtej njerëzve ndeshje lumenj malorë ashpërsisht të bukur, të ndotur nga mbeturinat e shtëpive, lokaleve dhe fshatrave gjeografikisht mbi to, hidrocentrale -apo projekte në veprim për to- dhe galeri minierash të braktisura, në fakt gropa të hapura në faqe malesh, një variant edhe më i nxitiuar shqiptar i goldrush-it kalifornian.

Këto ishin vepra të njeriut. Zoti e ka thënë fjalën prej kohësh. Një diell bujar mbi një ditë vjeshte me bukuri ngashnjese bëhej dëshmi e kësaj.

Kapluar me këtë ndjesi të dyfishtë, dora e njeriut dhe e Zotit mbi viset tona, bashkë me një kushëri- bir të këtyre anëve-, më kujtohej kryeministri Rama dhe premtimet me 'paketën e maleve' për shqiptarët në New York.

Edi Ramës nuk mund t'i kërkohej llogari për zbrazjen e Veriut, në të njëjtën kohë që flasim për vullnetin dhe lëvizjen e lirë të individit, por për politikën e tij dhe të qeverisë, po.

Aq më shumë për premtimet përleshëse si ky i 'paketës së maleve'. Sidomos kur ky premtim ka synim veriorët, dhe kur bëhet pas 12 vitesh në pushtet. Rama nuk mund të premtojë me synim mandatin e katërt, sikur të ishte një politikan që kërkon të parin. 'Paketa e maleve' në vetvete duket si një kombinim lehtësues i bukurive të Veriut me kërkesën për

turizëm malor të të huajve. Që këto të dyja të takohen, duhen bujtinat, hotelet, resortet, pistat e skive, lojrat dimërore etj.

Premtimi i Ramës është thujse cinik, sepse që këto të ngrihen, më shumë se leja e qeverisë kërkohej bashkëpunimi saj. Jo te investimet hoteliere, por te infrastruktura, hapi kryesor i së cilës janë rrugët. Rekordin e Ramës në infrastrukturë rrugore e njihni të gjithë, edhe në qofshi patronazhistë. "Rruga e Arbrit" është premtuar 12 herë dhe përruruar katër, por as është përfunduar dhe as është hapur.

Segmenti Vau i Dejës-Koman, edhe pse lidh një prej zonave më të bukura në Shqipëri, dhe shtrihet në atë segment që mban me energji elektrike gjithë Shqipërinë-pra i ka paguar shpenzimet e veta 100 milion herë- ende banon në fillim të viteve '90. Në këtë segment mund të gjeni dëshminë se si e la komunizmi Shqipërinë. Duhet mbi 2 orë të vështira për të përshkuar një segment që, në kushte normale, përmbillet në 45 minuta. Kjo rrugë do t'u mundësonte vendasve dhe të huajve një udhëtim dinjitoz drejt Tropojës përmes liqenit të Komanit deri në Fierzë. Në mungesë të saj ata futen në Tropojë nga Gjakova, pasi kanë kaluar nëpër gjysmën e Kosovës.

Nëse ia kujton këtë Ramës, me siguri

A DO TA HANË VERIORËT E DIASPORËS 'PAKETËN E MALEVË' TË RAMËS?



ta pret se ka bërë qendrën e Bajram-Currit, një prej atyre eksperimenteve esteto-enveriste ku të gjitha qytetet duken njëloj. Në Shkodër, duke nisur nga ura e Milotit, shkohet nëpër telin e tendosur të një rruge me një korsi, pa asnjë bordurë mbrojtëse. Rruga për në Mat ëshë e ngjashme me të Komanit.

Kukësi është i vetmi në hartën e qytetërimit falë Rrugës së Kombit, vetpër e Sali Berishës, infrastrukturën e të cilit Rama në opozitë e quante 'rrugët e mbetura rrugëve'.

Ky është rekordi i Kryeministrit aktual në raport me veriun në 12 vite në

pushtet. "Paketa e maleve" do të konsiderohej premtim serioz, dhe jo përleshës, vetëm nëse qeveria e tij do të blejë një flotë helikopterësh për transportin e udhëtarëve në këto anë.

Por, ai e di mirë se pse e bën këtë premtim në të cilin qeveria as ndihmon, as nuk pengon dot. Sa për propagandë.

U takon veriorëve në Diasporë që ta kuptojnë këtë. Ata vetë janë dëshmitarë të shprazjes të veriut në dekadën e fundit. Të izoluar ekonomikisht dhe politikisht, Edi Rama dhe qeveria e tij i ka trajtuar si qytetarë të dorës së dytë. Kjo politikë nuk ka qenë rastë-

sore, por e qëllimshme dhe ka patur si synim pjesëtimin e elektoratit të Partisë Demokratike dhe kapjen e bastioneve demokrate.

Në këtë kuptim gegët e Diasporës nuk mund ta lejojnë Ramën t'i grabisë 2 herë: një herë nga atdheu dhe herën e dytë nga mundësia e shpagimit personal. Çdo shqiptar që ka ikur sepse qeveria i ka zvogëluar atdheun, duke i lënë shkrepat e vendlindjes ose ikjen, si të vetmen alternative, duhet t'i thotë asaj qeverie që ta marrë 'paketën e maleve' dhe ta fusë aty ku ka vendin.

ROMEO GURAKUQI

Sakrificat, mundimet dhe arritjet e shqiptarëve në Greqi në këto 33 vite emigracion masiv dhe zhvendosjesh biblike të vendasve nga Shqipëria, nuk mund të kuptohen prej Tiranës dhe aq më pak nga ata që nuk janë mësuar të punojnë as në vendin e vet, nuk e dinë kuptimin e punës pa fund, kur dita nuk të mjafton, nuk njohin çfarë është trajtimi i njëllotë i qenieve njerëzore.

Shqiptarët kanë kapërcyer male fizike dhe masive vështirësish të gjithanshme, dhe ia kanë dalë të spikasin, me punë të ndershme, inteligjencë dhe pa u zbrapsur. Askush nuk i njeh këto vuajtje dhe përkushtime sublime më mirë se sa prinderit e tyre.

Ata janë njerëz të fortë, shumë të fortë madje, dhe sot, edhe të arrirë dhe të suksesshëm, që shoqëria greke i respekton dhe vlerëson për rezultatet e gjithanshme.

Fëmijët e tyre të lindur në Greqi ndjekin me vendosmëri shembullin e

prindërve mërgimtarë dhe janë shtetas të trajtuar në mënyrë të barabartë në atë vend.

Ata kanë marrë në vendin fqinj, atë që u ka munguar në Shqipëri: drejtësinë e trajtimit, gëzimin e njëllotë të të mirave që ofron një shoqëri demokratike, hapësirën për zhvillimin e papenguar, prej marrezhish primitive, të talentit.

Greqia nuk është ajo që njohim nga Beleris dhe shoqëruarit e tij të pafame, as ajo e thirrësve racistë dhe antishqiptarë. Ajo në shumicë është edhe një tjetër, e njerëzve të zakonshëm, humanë, qytetarë dhe evropianë. Është një shoqëri e ligjit dhe e të drejtës së pacenue, që shërbehet pa u vonuar.

Ndërkohë, një brez i ri i emigracionit, i lindur nga kriza permanente politike dhe ekonomike në Shqipëri, i është bashkangjitur me valë mërgatës së parë të madhe. Dhe shteti shqiptar sot ka për detyrë që ta mbështesë atë, se



paku me marreveshje dypaleshe, punën e tyre, sigurimin e tyre, garancinë e pacenueshmerine e të drejtave civile dhe shperblimin e drejte dhe te barabarte per produktin. Po ashtu, ne raportet me vendin fqinj

dhe mik, kerkohet seriozitet dhe kompetence e larte, per nje numer ceshtjesh te rendit te pare, te cilat mund te zgjidhen, duke lene pas te shkuaren dhe duke vendosur ne komunikim arsyen europiane dhe jo batuten.

Rasti i djeshem i skenave te dyfishta me reagime te perkundera ne Selanik eshte nje thirrje mendjeje ne fakt, per ata qe kane ne dore fatet e Shqiperise: Ata ulerasin dhe kerkojne rindertimin e drejte dhe te ndershem te Shtepise Sone me Emrin Shqiperi.

Vendi yne eshte ne fakt nje i semure rende, qe vuan nga mungesa e nje Zoti te Pergjegjshem te Shtepise, i cili rikthen binaret mbajtes nen kontroll, nen drejtesi dhe sherbim ndaj publikut.

Shqiperia nuk mund te kete stabilitet kur gjithandej ne skenen e komandes dhe kandidatures per komande, shfaqet egersia, dhuna, inkompetenca uluritese, zaptimi.

Vendi pret nje qasje krejt tjetër të sjelljes politike, një ekspertizë cilësorë mbi diagnostikimin e sistemit të deformuar që kemi krijuar dhe të kualitetit profesional të drejtimit.

SHQIPTARËT E GREQISË...

DRITAN GOXHAJ

MEDVEGJA E LUGINA NË PROTESTË, SHQIPËRIA NË FESTË

Para pak ditësh, me datë 3 nëntor, shqiptarët e Medvegjës, Bujanocit dhe Preshevës u mbledhën sërisht, për herë të tretë për të protestuar kundër ligjit të shtetit serb për Vendbanim dhe Vendqëndrim, që ne e njohim si ligji për Pasivizimin e adresave.

Këtë herë shqiptarët e këtyre trevave u mbledhën për të protestuar në Medvegjë, pasi kjo komunë në Jug të Serbisë është komuna më e prekur nga ky ligj.

Shumë here është folur për këtë ligj, por çfarë është ai në vetvete?

Ligji për Vendbanim dhe Vendqëndrim është miratuar në vitin 2011 nga autoritetet serbe edhe me mbështetjen e madhe të atëhershme të komunitetit ndërkombëtar në Beograd, pasi autoritetet serbe e paraqitën si të domosdoshëm këtë ligj, me arsyetimin se duhej për të pastruar listat e votuesve.

Por në të vërtetë, qëllimi i vërtetë i këtij ligji, ashtu siç edhe u vërejt më vonë, kishte të bënte vetëm me diskriminim të minoritetit shqiptar në Jug të Serbisë dhe veçanërisht me atë që jeton në komunën e Medvegjës, pasi kjo komunë në atë kohë ishte e banuar nga një popullsi e konsiderueshme shqiptare, por që nuk përbënte shumicën në këtë komunë ashtu siç përbën shumicën në dy komunat e tjera, Preshevë dhe Bujanoc.

Në komunën e Medvegjës sipas statistikave të vetë Ministrisë së Punëve të Brendshme të Serbisë, janë fshirë nga Regjistri civil i kësaj komune vetëm për periudhën 2015 deri në 2019, 4 mijë shqiptarë.

Mbas mbarimit të luftës në Kosovë më 1999, por edhe pas ndërprerjes së konfliktit në Preshevë, Medvegjë e Bujanoc në vitin 2001, në këto komuna jetonin aso kohe rreth 100 mijë shqiptarë, ndërsa sot si rezultat i represionit politik, policor dhe administrativ të Serbisë ndaj shqiptarëve në trojet e tyre etnike, në këto komuna kanë mbetur rreth 73 mijë shqiptarë.

Ajo që e ka pësuar më së shumti është komuna e Medvegjës me qëllimin e vetëm që ta kthejnë atë në komunë serbe dhe këtë autoritetet e Beogradit nuk e kanë mohuar asnjëherë. Sido-



mos sa herë ka zgjedhje lokale ata tashmë deklarohen se kjo komunë është komunë serbe dhe jo shqiptare.

Shumë nga ju do thonë që derisa është një vendim administrativ atëherë shqiptarët atje mund ta kundërshtojnë këtë vendim në gjykata.

Sipas këtij ligji nëse gjatë verifikimit të adresës së vendbanimit qytetari nuk gjendet në shtëpi, atij i pasivizohet adresa e përhershme e vendbanimit. Normalisht duhet t'i lëshohet një vendim i cili të jep një periudhë kohore vetëm prej 8 ditësh për të bërë ankesë në zyrat lokale të policisë. Pavarësisht se ai mund të mos jetë në atë kohë fare aty. Dhe ajo çka është edhe më problematikja, autoritetet serbe nuk lëshojnë fare një vendim me shkrim që dëshmon se iu është pasivizuar adresa.

Në shumicën e rasteve, sidomos viteve të fundit, kjo informatë u jepet vetëm gojarisht, në mënyrë që të mos

kenë mundësi të ankimohen në asnjë gjykatë derisa të kalojë afati 8 ditor. Dhe kjo bëhet qëllimisht që edhe në të ardhmen shqiptarët në këto komuna të mos mund të fillojnë procese ligjore kundër Serbisë për shkelje të rëndë të drejtave të tyre dhe diskriminim sistematik që po iu bëhet në baza etnike.

Ky pasivizim nuk është asgjë tjetër veçse një pastrim etnik modern. Çdo personi që i është pasivizuar adresa i refuzohet trajtimi mjekësor në spitale edhe pse posedon letërnjoftim të vlefshëm dhe sigurim shëndetësor. Po ashtu, qytetarëve të cilëve iu skadon letërnjoftimi nuk iu lejonet të marrin letërnjoftim të ri ose pasaportë dhe si pasojë as nuk marrin dot pjesë në votime.

E gjithë kjo bëhet me qëllim që këta shqiptarë pastaj të detyrohen të largohen nga këto komuna, ose duke u regjistruar në komuna të tjera të Serbisë si në Beograd, ose në Novi Sad

ku iu lejonet regjistrimi i ri pa asnjë problem, ose të largohen fare nga Serbia në drejtim të Kosovës.

Qasja politike e Beogradit zyrtar ndaj komunitetit shqiptar ka mbetur e njëjtë ashtu siç ka qënë në vitet 90' e 99', që do të thotë se Vuçiçi dhe politika serbe kanë mbetur të njëjtët antishqiptarë që kanë qënë, kur ishin nën pushtetin e Millosheviçit por edhe tashmë që pushtetin e ka vetë.

Fatqësisht, përkundër këtij diskriminimi sistematik të shqiptarëve në Medvegjë Luginë (Preshevë, Bujanoc), as Prishtina e as Tirana zyrtare nuk janë deklaruar asnjëherë për këto ngjarje.

Të dyja vazhdojnë të njëjtën qasje ndaj këtij fenomeni të pastrimit etnik, vazhdojnë të jenë indiferente ndaj ndaj këtij shpopullimi të qëllimshëm e diskriminimi sistematik të shqiptarëve në Serbi, i favorizuar totalisht nga heshtja e Prishtinës dhe më së

shumti, nga heshtja dhe indiferentizmi i vetëdijshëm dhe i programuar i Tiranës zyrtare, pasi kjo e fundit e ka edhe detyrim kushtetues që të reagojë për këtë pastrim etnik, sipas nenit 8 të Kushtetutës.

Por pavarësisht se shqiptarët në Medvegjë e Luginë (Preshevë, Bujanoc) është hera e tretë që protestojnë të vetëm, a keni dëgjuar që Ministria jonë e Punëve të Jashtme të ketë thërritur qoftë edhe një herë të vetme ambasadorin serb në Tiranë për t'i shprehur shqetësimin e qytetarëve shqiptarë të Medvegjës dhe Luginës (Preshevë, Bujanoc)?

Po kryeministrin që mbeti duke bërë festa me pensionistët nëpër qytetet e Shqipërisë, a e keni dëgjuar qoftë edhe një herë të vetme që ta ngrejë këtë shqetësim jetik dhe kombëtar të Shqiptarëve në Medvegjë dhe Luginë (Preshevë, Bujanoc)?

Jo nuk besoj se e keni dëgjuar dhe as që do e dëgjoni, pasi ai është i zënë me hallet e Ukrainës dhe mbështetjen që i duhet t'i japë terrorizmit izraelit, pastrimit etnik dhe genocidit ndaj palestinezëve, kështu që nuk mundet që të dalë kundër pastrimit etnik që sivëllai i tij Vuçiçi bën ndaj shqiptarëve në Medvegjë e Luginë (Preshevë, Bujanoc).

Po Kryetaren e Parlamentit, "Mamica" Spiropalin e keni dëgjuar që të shprehë ndonjëherë këtë shqetësim? Po Presidentin e Republikës a e keni parë ose dëgjuar që të ngrihet në nivelin e detyrës së tij si garant i Kushtetutës që të mbrojë të drejtat kombëtare të shqiptarëve në Medvegjë e Luginë (Preshevë, Bujanoc)?

Po politikën shqiptare majtas e djathtas e keni dëgjuar të shprehjet e të mbajë qëndrim për këtë problem të shqiptarëve në Medvegjë e Luginë (Preshevë, Bujanoc)?

Jo nuk i keni dëgjuar e nuk do i dëgjoni, pasi Serbia i ka kapur të gjithë peng.


Kësaj në këtë Shqipërinë tonë i thonë: fshati digjet e kurvat krihen.

POROSISNI BANNERIN PËR BIZNESIN TUAJ

- Business Cards
- Logo
- Flyers
- Video Marketing

Na kontaktoni: **020 7018 7929**

Dotech
website



TAULANT DEDJA

Pas ndërrimit të titullarit, duket se selia diplomatike e Republikës së Shqipërisë në Ottawa ka rënë përfundimisht nën kontrollin e bolshevikëve të rinj “rilindas”, besnikë të kryeministrit më të korruptuar në Europë, për shkak të politikave të të cilit, jo vetëm vazhdon shpopullimi i vendit, por edhe marrëdhëniet Shqipëri-Kanada janë në nivelin më të ulët historik të tyre që nga vendosja para 35 viteve. Arsytet se pse jemi në këtë nivel i kam përmendur në disa shkrime që lehtësisht gjenden në internet, por sigurisht ato i di mirë dhe diplomacia “rilindase”.

Megjithatë, për të besuar këtë pohim (sigurisht për ata që kanë sy e veshë të çliruar nga enverizmi dhe bolshevizmi) mjafton të shikosh se si u soll diplomacia kanadeze para pak ditësh, gjatë një konference ndërministrorë kushtuar Ukrainës në Montreal, e cila i rezervoi një vëmendje të veçantë prezencës së ministres së Jashtme të Kosovës, Donika Gërvalla, duke e injoruar totalisht ministrin e Jashtëm “rilindas” Igli H. që mezi mbledhi nja 15 nostalgjikë, konformistë apo naivë shqiptarë, diku në një rrugicë të metropolit frankofon.

Për të besuar këtë pohim, po ashtu mjafton të bësh një kërkim në faqen e Parlamentit Kanadez dhe aty do shohësh se ekziston një grup parlamentar miqësie Kanada-Kosovë, por jo një grup miqësie me Shqipërinë, siç është trumpetuar për vite me radhë se ekziston. “Fantazma” e grupit inekzistent, një deputete Liberale e Torontos, është takuar dje në mos gaboj me kryepatronazhisten e selisë diplomatike në Ottawa dhe na paskan diskutuar se si mund të bashkëpun-

BOLSHEVIKËT E DIPLOMACISË “RILINDASE” NË KANADA NUK E HARROJNË “NËNËN PARTI”




Ambasada e Republikë...

1j · 🌐

Në kuadër të 80-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë si edhe muajit të Trashëgimisë shqiptare në Ontario, Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Kanada ju fton në shfaqjen e filmit “Tana”, me regji të Kristaq Dhama dhe skenar të Fatmir Gjata, Nasho Jorgaçi dhe Kristaq Dhama.



Data: 8 Nëntor 2024



jnë për të mbështetur komunitetin “hallexhi se-lenicas” në Kanada.

Sigurisht, titullarët e sotëm të selisë diplomatike, si i mëparshmi, përpiqen ta mbulojnë dështimin total duke rendur pas “komunitetit” apo duke qarë hallet e “komuniteti të Selenicës”, a thua se shqiptarët e Kanadasë kanë ardhur nga oqeani më anije të rrëmbyera apo duke kapërcyer male, e kërcënohen nga ndonjë “fshesë”.

Por ndërsa titullari i mëparshëm i cili vegjetoj 8 vjet (duke nënshkruar vetëm një marrëveshje të cilën e kishin negociuar e përfunduar dy titullarët e mëparshëm) si diplomat karriere dinte ta ruante ekuilibrin për çështje delikate që lidhen me historinë e afërt të dhimbshme të shqiptarëve, kryepatronazhistja e sotme vepron me di-

rektiva bolshevike duke i shërbyer haptas “idealit bolshevik” të pasardhësve të ish-Bllokut famëkeq që sot e kanë kapur Shqipërinë prej fyti.

Besoje se njoftimi i publikuar para dy ditësh (shikoni foton më poshtë që mu duk e denjë të bashkëshoqërohet me simbolin e Sigurimit të Shtetit) në faqen e rrjetit social Facebook të Ambasadës shqiptare në Ottawa (që mbahet me taksat e gjithë shqiptarëve) nuk ka nevojë për shumë koment. Aty permendet muaji Nëntor, “festa e çlirimit të komunistëve” (absolutisht jo edhe festa e Pavarësisë) dhe aktiviteti më këtë rast organizohet pikërisht nesër, më 8 nëntor 2024.

Kush e ka provuar në lëkurë diktaturën enveriste sigurisht e di mirë se çfarë simbolizon 8 nëntori famëkeq. Sigurisht, të lindurit pas 1990-ës, që

shpesh ngazëllesh në foto me ambasadorë e ministra, nuk kanë si të na kuptojnë, e mbase u dukemi jashtë realiteti me këto që kujtojmë.

A mendoni se zgjedhja e një dite të premte 8 nëntor ora 18:00 (pse jo e shtuna 9 nëntor?) për të shfaqur filmin e parë të kinematografisë komuniste shqiptare është një rastësi?

Absolutisht jo sipas meje. Ndaj dhe mendoj se ky është një veprim skandaloz dhe një provokim i paskrupullt që duhet denoncuar publikisht, sepse jam i bindur që fyen të gjithë ata që në një mënyrë apo në një tjetër e vuajtën diktaturën e partisë bandite që u krijua më 8 nëntor 1941, nën kujdesin e veçantë të jugosllavëve për të zezën e shqiptarëve, të cilët ende sot vazhdojnë të vuanë pasojat e regjimit gjakatar që ajo sollti në fuqi pas luftës “antifashiste nacional-shkatërrimtare”. fasshqip.ca

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazon biznesin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



FJALË DHE LULEBORE NË KOPËSHTET E ZEMRËS VEPRA DHE ZËRI I AUTORES SË RE AMINE MESHNUNI

Promovimi i librit më të fundit të Amine Meshnuni, Lëng Shege mbi Lule Bore, ishte një natë që do të mbahet mend gjatë. I mbajtur në Ambasadën e Kosovës në Londër, ky event mbledhi bashkë diplomatë, figura letrare dhe mbështetës dashamirës së letërsisë bashkëkohore, të gjithë me një kuriozitet ndaj rikthimit të Amine Meshnuni-t në skenën letrare.

Redaktori dhe mentori i saj prej kohësh, Bedri Zenel Islami (Poet, romancier, estetolog, eseist, politolog, & analist, autor i mbi 30 librave jo vetëm letrarë, ndau mendimet e tij mbi udhëtimin artistik të autores. Ai kujtoi me gjallëri pritshmëritë e tij për rikthimin e saj pas një periudhe heshtjeje krijuese.

Në fjalimin e tij, Islami theksoi thellësinë dhe evolucionin e veprës së Amine Meshnunit, duke vënë në dukje se si poezia dhe proza e saj tani pasqyrojnë një zë të matur dhe të menduar. Islami nënvizoi se tani, "poezia e saj vjen e plotë," duke kombinuar bukurinë e gjuhës me tematika të thella, ku dhimbja dhe shpresa ndërliken në mënyrë të natyrshme. Vlerësimet e tij ishin një shprehje e përmbushjes së pritshmërisë së madhe për mënyrën se si shkrimet e Amine Meshnunit, dikur të brishta, tani rrezatojnë besim dhe bindje.

Në fjalën e saj, Meshnuni e përshkroi natën si një moment të veçantë dhe emocional për të: "Ishte një natë që do e mbaj mend gjatë," tha ajo, duke e krahasuar krijimin e veprës së saj me një feniks që ngrihet nga hiri, simbolizim i rilindjes së saj në botën letrare dhe një rikthim në rrënjët e saj. Ajo shprehu falënderimet e saj të thella ndaj Ambasadës së Kosovës dhe ambasadorit Ilir Kapiti për mikpritjen e ngrohtë, si dhe ambasadorit të Shqipërisë, Uran Ferizi, për pjesëmarrjen dhe vlerësimin e tij.

Meshnuni gjithashtu falënderoi redaktorin e saj, Islami-n, duke e përshkruar si "fenerin udhëzues" përmes sfidave të saj krijuese, dhe shprehu mirënjohje për familjen e saj, veçanërisht për motrën e saj Anise Meshnuni, e cila dha një performancë emocionuese në piano.

Mbrëmja ishte një kombinim harmonik i kulturës, artit dhe emocioneve. Performanca e Anise Meshnuni-t në piano krijoi një atmosferë magjike, ndërsa profesoresha e njohur Djana Kocija (Mësuese e Gjuhës dhe Letërsisë, Themeluese dhe Drejtoreshë e Shkollës Shqiptare në Mbretërinë e Bashkuar - Iliria) recitoi vargje të zgjedhura që preknin thellë të pranishmit. Midis folësve të tjerë të shquar ishte dhe Rema Duli (Kryetare e bordit të



drejtorëve në forumin avokues për të drejtat e azilkerkuesve në Londër & Drejtoreshë egzekutive dhe themeluese i "Rinisë Shqiptare Kosovare Kundër Dhunës (KAYAV)" & Menaxhere e Rimëkëmbjes dhe Mirëqenies së Shëndetit Mendor në MIND), një avokate e njohur për të drejtat e grave, e cila përgëzoi përkushtimin e Meshnuni-t ndaj letërsisë dhe shpirtin e saj krijues të lirë.

Ky event ishte dëshmi e qartë e rritjes së autoritetit letrar të Amine Meshnuni-t. Siç vunë në dukje të pranishmit, përfshirë shkrimtarë, aktivistë dhe diplomatë, Lëng Shege mbi Lule Bore nuk përfaqëson thjesht një moment të rëndësishëm në karrierën e saj, por dëshmon aftësinë e saj unike për të ndërthurur gjuhën, emocionet dhe përvojat nga vendlindja me temat universale të dashurisë, humbjes dhe qëndresës.

Audienca u largua me një ndjenjë pritshmërie për atë që e ardhmja rezervon për këtë autore të talentuar. Siç tha me elokuençë Bedri Islami, "Ngutja është krijesë e verbër, unë dua të shoh një botë të tërë." Dhe me këtë vepër të fundit, Amine Meshnuni është në rrugën e duhur për të na treguar atë botë – një poezi, një tregim, një herë në një kohë.



FITORJA E TRUMP/ ANALIZA: PRITSHMËRITË NGA ADMINISTRATA E RE AMERIKANE NË KOSOVË

Udhëheqësit në Kosovë, presidentja, kryeministri dhe drejtuesit e të gjitha partive politike në Kosovë, uruan ish-presidentin amerikan Donald Trump për fitoren në zgjedhjet e së martës duke shfaqur shpresën për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit me Shtetet e Bashkuara.

Mandati i parë i Presidentit Trump në Shtëpinë e Bardhë u karakterizua nga marrëdhënie të tensionuara me qeverinë e parë të kryeministrit Albin Kurti. Shtëpia e Bardhë siguroi një marrëveshje për normalizimin e marrëdhënieve ekonomike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë e cila u nënshkrua në shtator të vitit 2020 në praninë e presidentit Donald Trump. Marrëveshja u nënshkrua disa muaj pas rrënies të qeverisë së parë të kryeministrit Kurti i cili nuk u pajtua me kërkesat amerikane për heqjen e tarifave prej 100 për qind ndaj mallrave serbe që ishin vendosur në nëntor të vitit 2018 si kundërpërgjigje ndaj qasjes së Serbisë ndaj shtetësisë së Kosovës.

Lidhja Demokratike e Kosovës e cila ishte pjesë e pushtetit, u tërhoq nga koalicioni duke çuar në rrëzimin e qeverisë së zotit Kurti, që u pasua nga një qeveri e re që nënshkroi marrëveshjen në Washington.

Kryeministri Albin Kurti në atë kohë akuzoi të dërguarin amerikan Richard Grenell se “është përfshirë duke çuar përpara votimin që rrëzoi qeverinë” e tij. Grenell, një bashkëpunëtor i ngushtë i zotit Trump është përfolur si kandidat për postin e Sekretarit të Shtetit në administratën e ardhshme të presidentit Trump.

Analisti Agon Maliqi thotë për Zërin e Amerikës se pritshmëritë janë që zoti Grenell të angazhohet përsëri për rajonin.

“Se si do të ndikojë kjo pastaj mbetet të shihet nga konstelacioni i qeverisë së re në Kosovë, nga mënyra se si Bashkimi Evropian sillet dhe në këtë moment është pak e vështirë të parashikohet”, tha ai.



Zoti Maliqi thotë se megjithëse e kaluara ka pak ndikim në politikë, shqetësueset mbetet qasja e qeverisë së Kosovës ndaj administratave amerikane.

“Gjatë (administratës) Biden edhe pse kishim mospajtme të thella, pakënaqësi shumë të qartë të shprehur nga administrata Biden megjithatë kishte edhe një lloj mirëkuptimi mbi veprimet e qeverisë së Kosovës dhe një lloj tolerance për këtë lloj qasje, gjë që dyshoj se mund të vazhdojë me një administratë amerikane e cila jo vetëm në raport me Kosovën por me pothuajse çdo aleat të SHBA-ve e ka një qasje transnacionale në kuptimin që ‘ne do të jemi me juve për aq sa ju do të jeni me neve’”, tha ai.

Një çështje që mori shumë vëmendje

gjatë mandatit të parë të Presidentit Trump ishte edhe ideja e shkëmbimit të territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë si zgjidhje paqësore ndërmjet dy vendeve.

Diskutimet zunë fill në verën e vitit 2018. Këshilltari për Sigurinë Kombëtare i Presidentit Trump, John Bolton, i cili u largua nga posti, më 24 gusht të atij viti tha se “Shtetet e Bashkuara nuk do të përfshihen në idenë për shkëmbimin e territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, por nëse palët merren vesh, nuk do të bëhen pengesë”

Një ditë më pas presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi dhe ai i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, në një debat gjatë forumit të Alpbachut në Austri, kërkuan mbështetjen ndërkombëtare për çfarëdo marrëveshje që mund të arrihej në bisedimet e ndërmjetësuar nga

Bashkimi Evropian, edhe nëse ajo nënkuptonte ndryshim kufijsh.

Kjo ide u prit me reagime të ashpra në Kosovë dhe në Serbi, si dhe u kundërshtua nga një pjesë e vendeve të Bashkimit Evropian mes të cilave Gjermania ishte më e zëshmjta.

I dërguari i Shtëpisë së Bardhë për dialogun Kosovë-Serbi, ambasadori Richard Grenell, mohoi disa herë që Shtetet e Bashkuara të kenë qenë pjesë e diskutimeve për shkëmbim territorësh.

Këtë javë, kjo çështje u ngrit gjatë një seance dëgjimore në Parlamentin Evropian për konfirmimin e kandidatit për postin e komisioneres së zgjerimit të Bashkimit Evropian, Marta Kos, e cila tha se është kundër tendencave për shkëmbim të territoreve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë.

“Sa i përket shkëmbimit të territorit, jo, jo, nuk bëhet fjalë. Komisioni Evropian dhe unë, nëse konfirmohem, nuk do t'i ndjekim këto tendenca”, tha ajo e pyetur nga deputeti sloven Vladimir Prebilic.

Analisti Agon Maliqi tha për Zërin e Amerikës se e sheh të vështirë rikthimin e një ideje të tillë veçanërisht pasi dështoi njëherë. Por sipas tij, një mundësi e tillë varet edhe nga suksesi i procesit aktual të dialogut të udhëhequr nga Bashkimi Evropian.

“Sa më shumë që zgjidhet procesi i Brukselit pa zgjidhje dhe zvarritet më shumë gjithçka është e mundur. Edhe herën e kaluar kur u hap kjo temë ishte befasi. Sa më shumë që dështon dialogu i Brukselit për ta zgjidhur kontestin në kornizën e marrëveshjes së Ohrit gjithnjë e më shumë hapen mundësitë për zgjidhje tjera alternative sepse edhe Kosova edhe Serbia po mbesin peng dhe rruga e tyre integruese, sidomos te Kosova te strukturat euro-atlantike nuk është askund”, tha ai.

Megjithatë, sipas zotit Maliqi, Kosova e cila është lënë në sanksione nga Bashkimi Evropian dhe me ndryshimin e administratës në Washington duket se do të gjej vetën në një realitet të ri.

“Ajo që duhet thuhet gjithsesi është se Serbia në këtë moment ndihet në pozitë pak më të mirë, që jo detyrimisht do të jetë e vërtetë, por perceptimi dhe ndjenja në Beograd është se tani ata do të përballen me më pak presion rreth çështjes së dialogut apo se ata mund të kenë më shumë ndikim në diktimin e parametrave të dialogut dhe kjo është diçka që në Prishtinë duhet të kenë parasysh”, tha analisti Agon Maliqi./VOA



NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES

ANDI BUSHATI

Ç'MUND TË PREDIKOJË AMBASADA AMERIKANE PAS FITORES SË TRUMP?

Pas zgjedhjes së njeriu të krengritjes së dhundhme të 6 janarit dhe atij që drejtësia amerikane u përpoq ta pengojë për të garantuar

Fitorja tronditëse e miliardarit të konvertuar në politikë, Donald Trump, e cila do të ushtrojë ndikim në pikat më të nxehta të globit, nuk do të kalojë e pavërejtshme as në provincën tonë të vogël dhe të largët.

Nëse në SHBA, ai do të ketë një fuqi absolute, duke kontrolluar edhe senatin, që kaloi në shumicë tek republikanët, me shumë mundësi edhe kongresin e sëbashku me to edhe Gjykatën Supreme; nëse mbi NATO-n, Ukrainën, apo çështjen palestineze efektet e kësaj fitoreje priten të jenë rënqethëse; për Shqipërinë mund të ketë vlerë mënyra sesi ai u zgjodh dhe rruga që ndoqi për t'u bërë i dyti president në historinë e Amerikës, që rikthehet në Shtëpinë e Bardhë pasi është larguar njëherë prej saj.

Në kontekstin tonë aktual është e rëndësishme të shikohet se si bëri për vete zemrën e shumicës së amerikanëve një njeri që kundërshtoi me dhunë rezultatin e zgjedhjeve që i lëshoi thirrje mbështetësve të tij të sulmonin Kapitolin, se si i'a doli ai të fitonte pavarësisht çështjeve të panumurta hetimore dhe proceseve që i hapën.

Po ta shqyrtosh në thelb, ky rrugëtim bie ndesh me të gjitha predikimet që diplomatët dhe zyrtarët amerikanë të nivelit të mesëm dhe të ulët, predikojnë prej vitesh për Shqipërinë.

Në 6 janarin e katër viteve më parë, pasi nuk kishte njohur fitoren e kundërshtarit të tij Joe Biden, të certifikuar nga të gjitha institucionet, pasi kishte bërë titur pa prova të qara se vota e tij ishte vjedhur, Trump që ende nuk kishte dalë nga presidenca, i bëri thirrje mbështetësve të tij të ndesheshin për të rifituar Amerikën. "Nëse nuk luftoni për demokracinë vendi juaj do të zhbëhet", i tha ai turmave duke u premtuar se do të marshonte bashkë me ta drejt Kapitolit për t'i bërë presion kongresmenëve që të mos miratonin rezultatet e prtetenduar si të trukuara.

Ndonëse numri i të vdekurve shkoi në katër, megjithë skenat e dhunës dhe shkatërimin brenda kongresit amerikan, Trump vazhdoi ti quante sulmuesit "njerëz specialë" dhe të shkruante në Twitter se i "dashuronte" ata që nuk e pranonin vjedhjen e pavërtetuar të votës.

Katër vite më pas, amerikanët e dërguan këtë profil politikani në krye të vendit të tyre. Por, pas gjithë kësaj, a nuk duken qesharake deklaratat patetike të ambasadës së SHBA në Tiranë, kur digjet ndonjë karrige në kuvend, kur hidhet ndonjë fishekza-



jrre mbi kryeministri, apo kur zhgarravitet ndonjë mur i bashkisë?

Nejse, këto episode simbolike, që tregojnë se popujt nuk ndjejnë të njëjtën frikës nga stabiliteti sa dhe burokratët që reagojnë nga errësira e zyrave të tyre, janë vetëm ana sipërfaqësore e asaj se si fitorja e Trump mund të përkthehet këtej nga anët tona. Thelbi qëndron tjetërkund. Dhe ai lidhet me surprizën shokuese të një kandidati, të cilin, përndjekja nga sistemi i drejtësisë i vendit të vet, nuk e pengoi dot të fitonte. Që kur u zhvesh nga posti, Donald Trump është përballur me një numër të pafund procesesh penale dhe civile. Penalisht ai u hetua për ndërhyrje në zgjedhje, për manipulimin e dokumentave të klasifikuar, për tentativat e korrupsionit të pornostares Stormy Daniels, që mos fliste kundër tij, si dhe për sulmin mbi Kapitol. Përpos këtyre ai u përball me procese civile për fshehje taksash dhe agresion seksual. Qëllimi i gjithë

kësaj fushate u akuzua nga mbështetësit e vet republikanë si një tentativë për të penguar idhullin e tyre të garante në zgjedhje.

Por fillimisht, Gjykata Supreme e rrëzoi një pretendim të shtetit të Kolorados për ta nxjerrë Donald Trumpin nga gara presidenciale, ndërsa, këtë të martë, shumica e qytetarëve amerikanë e hodhën poshtë iluzionin se mund të ketë institucione, qoftë edhe ato të drejtësisë, që mund të përcaktojnë, në vend të tyre, se kë ata duan të zgjedhin në krye të vendit. Amerika dëshmoi se nuk e gëlltit dot instrumentalizimin e garës ose tkurrjen që një kastë e caktuar reket ti bëjë mundësive të pamata për të vendosur.

Por shembulli i kësaj Amerike, bie katërcipërisht ndesh me praktikën që zyrtarët e mandatuar prej saj po praktikojnë në Tiranë, ku me anë të të ashtuquajturës reformë në drejtësi, po nxjerrin nga loja elektorale të gjithë

rivalët e pushtetit. Të njëjtat metoda, të cilat dështuan të pengojnë Trumpin, po përkrahen në mënyrë të suksesshme nga diplomatët e SHBA për të nxjerrë jashtë gare krerët e partive opozitare shqiptare dhe për të zhbërë rezultatin e votës popullore, siç ndodhi në Himarë. Ata që kërcënuan zgjedhësit shqiptarë me "ngënie bari", që dhunuan çdo kod diplomatik duke bërë thirrje për të mos votuar për "non gratat", tani kanë zgjedhur të mbështesin një segment të drejtësisë, që pretendon të bëjë në ndryshimin e elitave politike duke shmangur dhe kapërcyer votën. Kjo është diametralisht e kundërt me verdiktin popullor të kësaj të marte.

Pra, si konkluzion, mund të thuhet se mbi 70 milionë amerikanë e kanë bërë të duket qesharake, qasjen që politika e jshtme amerikane po eksperimenton këtu tek ne. Por ama kujdes! Ndonëse duket sikur ky përfundim shkon në favor të opozitës

zyrtare në vend, e cila ka qenë e humbura e madhe e kësaj farse me drejtësinë, askush nuk duhet të ushqejë iliziuone se, këtëj e tutje, gjithçka derimisht do të ndryshojë për mirë.

Historikisht Amerika ka dëshmuar se vlerat dhe parimet që vlejnë për të, nuk janë të detyrueshme edhe për satelitët e vegjël që e ndjekin nga pas. Pikërisht ajo që filozofi dhe intelektual socialist, autori i "Një histori popullore e SHBA", Howard Zinn e konsideron si hipokrizia amerikane, nuk është çudi të përsëritet edhe këtë radhë.

Aq më tepër një lider kontrovers si Donald Trump nuk jep asnjë garanci për kultivimin e këtyre vlerave. Prandaj, ndonëse fitorja e miliardarit republikan e rrëzoi fabulën e deritanishme, nuk është e thënë se farsa e një autokracie me mbështetje amerikane nuk do të vazhdojë./lapsi

EMIN AZEMI

RAMA – MARANGOZ I ZOTI I SKENAVE KOMIKE, AKTOR I DOBËT NË SKENËN NDËRKOMBËTARE

Në gjeopolitikën rajonale dhe evropiane, Edi Rama është treguar se mund të jetë një marangoz i zoti për të ndër-tuar skenat komike të paraqitjeve të tij, por jo edhe një politikan kalibri serioz që përmes njohjeve me ndërkombëtarët do të sillte më shumë investime dhe më shumë siguri në tokat e shqiptarëve

Si i përkthejnë politikanët tanë në favore për kombin dhe shtetin njohjet personale të tyre me burrështetas të huaj dhe si e bëjnë këtë politikanët e tjerë të rajonit dhe më gjerë?

Çka përfiton Shqipëria, bie fjala, nga njohjet personale të Ramës me politikanët të huaj dhe çka përfiton Serbia, në anën tjetër, nga njohjet e Vuçiqit me homologët botërorë?

Ajo që bie në sy është se Edi Rama në çdo takim me karakter ndërkombëtar, përpos paraqitjeve jashtëserike (me batuta e me tuta), ka dëshmuar se posedon edhe aftësi magnetike për të bërë miq (dhe mikeshë) në mesin e burrështetasve të huaj. Ai është i shëruar nga kompleksi i inferioritetit dhe në komunikim me politikanët të huaj, përfshirë edhe presidentët amerikanë, të lë përshtypjen se është udhëheqës suprem i dy-tre kontinenteve të botës.

Mirëpo çka përfiton Shqipëria nga kjo paraqitje joinferiore e Ramës dhe nga këto miqësi të tij me politikanët të huaj?

Plehat dhe refugjatët afganë – trofetë e diplomacisë së Ramës!

Cinikët do të thoshin se nga gjithë ky kallaballëk miqsh e mikeshash që i ka Rama në arenën ndërkombëtare, dhe nga gjithë ai glamurozitet që mundohet ta inkarnojë me ngjyra paksa naive në portretin e tij kundrejt të huajve, Shqipëria gati asgjë nuk përfiton.

“Mallrat” më me vlerë që mund të konvertohen në diplomacinë e batutave dhe tutave të Ramës, rezultojnë të jenë vetëm plehat e Melonit dhe refugjatët e Afganistanit. Dhe këtu përfundon aftësia e Ramës për t’iu dhuruar shqiptarëve favorët që dalin nga miqësitë e tij me ndërkombëtarët. Madje as miqësia e tij me Vuçiqin nuk mund të konvertohet në kurrfarë vlere kombëtare për Kosovën dhe për shqiptarët në Serbinë e Jugut.

Kjo kërkon një analizë edhe më të thellë socio-politike e psikologjike për të kuptuar se ku qëndron kjo natyrë homodupelkse e politikanëve të Tiranës, të cilët paraqitjet i kanë shumë superiore, kurse veprimet praktike – shumë inferiore. Kjo ta kujton edhe kohën e Enverit, atëherë kur shqiptarët në Jugosllavi (vitet 50-60) vuanin nga terrori serb dhe shpërnguljet në Turqi, ndërkohë që Shqipëria ishte aleate e dy superfuqive – një herë me BRSS-në, herën tjetër me



Kinën.

Por, çka përfitonin shqiptarët e Jugosllavisë nga kjo aleancë e Shqipërisë me superfuqitë botërore? Përpos shtimit të dajakut serb mbi kurrizin e tyre, shqiptarët këndej Drinit përfitonin edhe ndonjë karamelle propagandistike që vinte nga Radio Tirana ku madhërohej Shqipëria socialiste e cila “e kishte të pamundur të pushtohet nga jugosllavët”, sepse “tanket serbe duhej të kalonin fillimisht mbi trupat e kosovarëve”(!).

Shihe ti ironinë: Shqiptarët e Kosovës atëbotë duhej t’i kryenin dy obligime kombëtare – në njërin anën t’i rezistonin represionit serb, kurse në anën tjetër të bëheshin mish për top për Shqipërinë socialiste, vetëm e vetëm që tanket serbe të mos mund ta pushtonin “kopshtin me lule” të xhaxhit Enver.

Dhe, për ironi të fatit, Shqipëria asnjëherë nuk u pushtua nga jugosllavët, por shqiptarët e Jugosllavisë as sot nuk e kanë të qartë se si ishte e mundur të kalonin aq keq në orën e historisë, duke mos arritur ta kuptojnë se ku e ka burimin gjithë ky inferioritet i udhëheqësve të caktuar të Tiranës ndaj politikanëve të Beogradit.

Çfarë përfiton Serbia nga miqësitë ndërkombëtare të Vuçiqit?

Po Vuçiqi, në anën tjetër, me

miqësitë që ka në Evropë e Azi, çfarë të mire po i sjell Serbisë?

Ai, për dallim nga Rama, nuk po heq dorë as një milimetër nga interesat kombëtare të serbëve të Kosovës, Bosnjës, Malit të Zi e gjetiu dhe për këtë nuk po koordinohet as me Brukselin, as me Ëashingtonin. Vuçiqi në çdo takim me Putinin, e shfrytëzon rastin të flet për Kosovën, se si ajo është e “okupuar” nga trupat e NATO-s, se si Perëndimi me dhunë e ka “aneksuar” Kosovën, se si padrejtësisht Dodiki është futur në “listën e zezë” amerikane etj. etj.

Tash së fundmi, edhe në takimet mikpritëse me Presidentin turk, Erdogan, Vuçiqi shpалosi një kapitull të ri marrëdhëniesh bilaterale, duke nënshkruar 11 marrëveshje bashkëpunimi me Turqinë, pa pasur nevojë që të marrë peshqesh ndonjë dhuratë (lexo: xhami grandioze) në këmbim të influencave shpirtërore-fetare mbi shoqërinë serbe...

Edhe në takimet me politikanët perëndimorë, Vuçiqi e nxjerr maksimumin në favor të interesave kombëtare serbe. Kur e priti në Beograd në vizitë Kancelarin gjerman Sholz, Vuçiqi e ka rishikuar projektin Jadar, i cili parashihet hapjen e një miniere të litiumit në luginën e Jadrës në Serbi nga gjiganti botëror, Rio Tinto. Me këtë rast është nënshkruar edhe një memorandum mirëkuptimi midis BE-së dhe qeverisë së Serbisë, në prani edhe të drejtuesve nga Mercedes-

Benz Group AG dhe Stellantis NV, për një “partneritet strategjik” mbi lëndët e para të qëndrueshme, zinxhirët e furnizimit me bateri dhe automjetet elektrike. Gjermania, prodhuesi më i madh i makinave në Evropë, përmes Serbisë do të sigurojë litium për prodhuesit e saj të automjeteve elektrike, kurse BE-ja po përpiket të reduktojë varësinë e saj nga importet nga Kina. Muajin e kaluar Vuçiqi i ka thënë Financial Times se miniera, të cilën ai pret të hapet në vitin 2028, do të prodhonte 58,000 ton litium në vit. Kjo do të ishte e barabartë me 17 për qind të prodhimit të automjeteve elektrike në Evropë ose 1.1 milion makina.

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Kombëtare e Serbisë, nga viti 2010 deri në tremujorin e dytë të vitit 2022, fluksi i investimeve të huaja direkte nga Bashkimi Evropian në Serbi arriti në 19,204 miliardë euro, nga Kina (përfshirë Hong-Kongun, Tajvanin dhe Macau) në 3,281 miliardë, nga Federata Ruse 2,473 miliardë dhe nga Shtetet e Bashkuara 733 milionë euro.

Gjatë 9 muajve të parë të vitit 2022, në Serbi kanë hyrë 3 miliardë e 11 milionë euro si investime të huaja, gati gjysma e të gjitha investimeve në Ballkanin Perëndimor. Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Qendrore e Shqipërisë, në periudhën janar-shtator 2023, investimet e drejtpërdrejta që kanë hyrë në ekonominë shqiptare janë 1,088 miliardë euro.

Të gjitha analizat e bëra deri më tani konstatojnë se Qeveria e Ramës duhej të bënte më shumë për të tërhequr investitorët e huaj të cilët kur bëhet fjalë për të investuar në rajonin e Ballkanit, shohin gjithmonë Serbinë dhe Kroacinë si vende favorite.

Ku qëndron enigma e këtij disavantazhi që ka Rama kundrejt Vuçiqit në raport me ndërkombëtarët, paçka se kryeministri shqiptar, mizanskenat e karamelizuara komike në margjinat e samiteve dhe takimeve të ndryshme botërore, nuk arriti asnjëherë t’i shndërrojë në asete strategjike investuese dhe asnjëherë nuk arriti ta sfidojë Vuçiqin në garën politike e diplomatike që do të sillte favore për Kosovën. Për ironi, ka ndodhur e kundërta. Rama në disa raste është bërë avokat i Serbisë duke e mbrojtur atë nga kritikët e BE-së për mosvënien e sanksioneve ndaj Rusisë. Madje, Rama, jo një herë, është sjellë më ndërkombëtarë se ndërkombëtarët, sa u përket disa çështjeve delikate nëpër të cilat kalonte Kosova, sidomos veriu i saj.

Njohja e Ramës me ndërkombëtarët, çfarë hajri ka pa Kosova dhe Shqipëria?

Nëse një politikan karizmatik si Rama e kemi parë t’ua hedhë dorën mbi sup shumë burrështetasve të Evropës dhe botës, atëherë shtrohet një pyetje shumë e logjikshme: Çfarë hajri ka parë Kosova dhe Shqipëria nga kjo afërsi e Ramës me këta burrështetas, qoftë edhe si avantazh kundrejt Vuçiqit? Apo ndoshta atë afërsi ai e ka rezervuar për t’i ushqyer synimet dhe ambiciet e veta karrieriste në ndonjë post të lartë në hierarkinë e politikës apo diplomacisë së BE-së, OKB-së NATO-s. etj. etj.

Nëse gjithë ky cirkus batutash e njohjesh të Ramës me ndërkombëtarët nuk ka prodhuar ndonjë favor për kombin shqiptar, atëherë po del se ai përveç që ka bërë lojën e një aktori tragjikomik, ka shuar për një kohë të gjatë edhe iluzionet dhe shpresat e shqiptarëve se miqësia me botën perëndimore mund të përkthehet në mirëqenie për kombin dhe shtetin e tyre.

Në gjeopolitikën rajonale dhe evropiane, Edi Rama është treguar se mund të jetë një marangoz i zoti për të ndër-tuar skenat komike të paraqitjeve të tij, por jo edhe një politikan kalibri serioz që përmes njohjeve me ndërkombëtarët, do të sillte më shumë investime dhe më shumë mirëqenie e siguri në tokat e shqiptarëve.

BEN BLUSHI

Sikur Donald Trump të mos mbajë asnjë nga premtimet që u ka bërë amerikanëve por vetëm të mbyllë luftërat, Amerika mund t'i bëjë botës një nga shërbimet më të mëdha që kur ky vend ekziston.

Në 100 vitet e fundit Amerika ka qenë luftënxitësja më e madhe e planetit dhe për fat të keq vazhdon të jetë. Kur shkruaj kështu e di që shumë njerëz do habiten. Si një planet i madh që drejton jetën e satelitëve që sillen rreth saj, Amerika nuk duket njëlloj nga çdo cep i botës.

Ne që jetojmë në një vend i cili edhe me ndihmën e Amerikës, shpëtoi nga komunizmi, besojmë se ajo ka të drejtë të pushtojë në emër të demokracisë. Nëse ushtarët amerikanë do vinin në Shqipëri në vitet 1970, sot ndoshta do ishim duke jetuar më mirë, do ishim një vend më i pasur dhe ndoshta pak më i madh. Por kjo nuk ndodhi. Amerika nuk erdhi.

Në ato vite Amerika shkoi në Vietnam për të luftuar komunizmin. Për fat të keq ky vend sot drejtohet ende nga komunistët dhe aty pluralizmi politik ndalohet me ligj. Nëse i pyet vietnamezët, ata do thonë se kjo është gjëja më e keqe që ju ka ndodhur në histori. Dhe kanë të drejtë.

Pasi ushtria amerikane u tërhoq, Vietnamit u stabilizua. Sot ky është një vend i hapur komunist, që lejon turizmin, tregtinë e lirë, investimet e huaja dhe ç'është me rëndësisht është i bashkuar. Nëse Amerika do e kishte fituar luftën në Vietnam ky vend do ishte i ndarë në dy, mes jugut dhe veriut, njëlloj si Korea. Sot do kishim dy Kore dhe dy Vietnam dhe me siguri një armë bërthamore më shumë, ndërkohë që Vietnamit as nuk ka, as nuk kërkon bombë atomike, sepse nuk është në luftë me asnjëri. Vietnamit është një vend i bashkuar që mundohet të lëpijë plagët e veta të paharrueshme.

Kur ikën, amerikanët lanë aty 3 milion të vdekur. Të gjithë vietnamezë. Ndërsa në Japoni 250 mijë u vranë në tre ditë.

Thonë që lufta nuk ka rregulla, por ka proporcionalitet, pra edhe kur vret duhet të respektohet disa parime. Duhet të vrasësh me masë. Kur të vrasin ushtarë, nuk mund të vrasësh civilë. Kur Japonia sulmoi një bazë detare të Amerikës në Luftën e Dytë Botërore, vrau 2400 ushtarë. Amerika ju përgjigj me armë bërthamore dhe vrau 250 mijë banorë civilë. Për çdo ushtar amerikan të vranë u shfarosën 100 japonezë duke shkuar në punë dhe që atë ditë kërcënimi bërtimor nuk i ndahet më botës.

Por, mesa duket demokracia nuk lind mbi varreza. Bilanci luftarak i Amerikës nuk shkëlqen. Vietnamit është ende një vend komunist, Koreja është e ndarë në dy pjesë, Afgan-



istanin e morën prapë talebanët, Siria është e shpartalluar, Iraku u bë djep i ISIS dhe sot ka përfunduar në një kukull të Iranit. Megjithëse këto pushtime u bënë në emër të demokracisë, demokracia nuk ka ardhur askund dhe ky dështim ka një arsye: popujt e pushtuar e refuzuan demokracinë si recetën e pushtesit.

Njerëzit që thonë se Amerika bën mirë që pushton në emër të demokracisë ngatërrohen sa herë shkojnë në Kubë. Askush nuk e kupton pse Amerika shkon aq larg për të luftuar komunizmin deri në Vietnam dhe Kore por nuk shkon në një ishull me 10 milion banorë, shumica e të cilëve kanë familjet në Amerikë. Tortura e atij populli të braktisur në mes të detit është pasqyra e zhgënjimit. Pse Vietnamit dhe jo Kuba? Pushtimi i Kubës do ishte edhe më i lirë sepse ky vend është më afër Amerikës se ç'është Vlora me Brindizin.

Për fat të keq sjellja e Amerikës në pyllin e botës i ngjan sjelljes së luanit. Veprimet e tij ndikojnë tek kafshët e tjera. Kur ai del për gjah të tjerët mbrohen, fshihen, ngjiten nëpër pemë, mbeten pa bukë, acarohen, ulërijnë, nxjerrin kthetrat, sulmojnë dhe vrasin kafshë më të vogla.

Nëse nuk do kishte ndodhur Hiroshima, Vietnamit dhe Korea, bota do ishte pa dyshim më paqësore. Kafshët e mëdha që duan të frenojnë luanin nuk do ishin armatosur prandaj Lindja e Mesme do ishte më e qetë, Irani nuk do kishte armë bërthamore, Rusia nuk do financonte një herë talebanët pastaj Iranin, Ukraina nuk do ishte pushtuar për shkak të parimit, ti pushton unë pushtoj, dhe terrorizmi islamik nuk do ishte kthyer në armë të vrasjes në masë.

Kur argumenti i shfarosjes së komunizmit ra, filloi ai i zhdukjes së terrorizmit. Amerika çoi ushtarë për të zhdukur terroristët dhe shtetet e tyre dhe natyrisht në disa raste bëri mirë. Çështja është se edhe para Amerikës

ka patur islam, siç ka patur shoqëri fetare dhe shtete muslimane. Ato kanë qenë më të varfëra por nuk vrisnin. Kur Britania dhe Franca kolonizuan Afrikën, Indinë dhe Arabinë nuk pati terrorizëm islamik.

Ky helm u shpërndo në 30 vitet e fundit, kur fuqitë e mëdha filluan të financojnë grupe islamike kundër njera-tjetrës duke i armatosur me armë dhe me urrejtje. Kështu u krijuan me rradhë Al Kaeda, ISIS, Hezbollahu, Hamasi dhe historia vazhdon në Palestinë që është kthyer në një shoqëri e marrë peng nga terroristët, ndërkohë që Irani është pothuajse një shtet terrorist.

Kjo çështje që vazhdon, ishte një nga tre arsyet kryesore që rrëzuan qeverinë amerikane në zgjedhjet e fundit.

Prandaj ne që jetojmë në këtë pjesë të botës ku komunizmi, fashizmi, nacionalizmi, dhe radikalizmi fetar mund të ndryshojnë kollaj vendet, duke na kaluar një herë në shi, një herë në breshër dhe pastaj në thatësisë, kemi arsye të besojmë se Amerika po ndryshon. Ne duam që Amerika të ndryshojë si ata njerëzit që presin me sytë nga dielli kur dimri i lë vendin pranverës.

Të zgjohesh një ditë dhe të dëgjosh se Amerika nuk do më luftë është njëlloj sikur të shikosh daljen e dritës nga një re që ka zgjatur njëzet vjet. Retë, pra luftërat dhe frika e tyre ka shumë vjet që kanë nixirë horizontin e botës sonë. Për shkak të luftërave çdo gjë ka ndryshuar dhe po ndryshon me shpejtësi.

Për shkak të Ukrainës, çdo centimë beton në Shqipëri është 50 për qind më shtrenjtë se para luftës. Por kështu është me të gjitha çmimet që nga mielli, nafta e deri te perimet të cilat ushqehen me fertilizues që dikur vinin më lirë nga Lindja. Inflacioni që u dy dhe trefishua vazhdon t'i varfërojë të gjithë, jo vetëm me Shqipëri dhe bota para Luftës në Ukrainë duket si një

parajsë e humbur e çmimeve të lira që ndoshta nuk do kthehet më kurrë.

Kjo është bota që kemi humbur sepse liberalët amerikanë dhe ata evropianë nuk arritën dot një kompromis me Rusinë. Ata ndoqën fiksimin e tyre të vjetër, se Rusia është armiku që duhet mundur duke harruar se e kishin mundur një herë në vitin 1990 si Bashkim Sovjetik. Ta rrahësh një qen dy herë për kaq pak kohë, e ke shtyrë të kthehet në ujë dhe të kafshojë siç po bën. Po kafshon pjesët e buta të Evropës, kofshët e saj të zbuluara.

Fiksimi i liberalëve amerikanë për të shkatërruar Rusinë duke përdorur një herë Vietnamin, pastaj Korenë, pastaj Afganistanin dhe tani Ukrainën e ndau botën, e militarizoi në ekstrem, varfëroi shumë Evropën, forcoi Kinën, inkurajoi Hamasin dhe Iranin, rriti çmimet dhe inflacionin edhe në Amerikë dhe ua humbi atyre zgjedhjet.

Kjo humbje e luftënxitësve ishte lajmi më i mirë i dy dekadave të fundit.

Prandaj sot Donald Trump është një mundësi për botën tonë. Sjellja e tij me taksat, me gjykatat amerikane, me dokumentat sekretë, me gratë, me abortet dhe me shtypin nuk janë arsye për të shkuar në luftë. Gjatë gjithë fushatës, ishte qesharake të dëgjoje se sa herë ai thoshte do mbyll një luftë, kundërshtarët liberalë i thoshin, nuk duhet ta bësh sepse ke ngacmuar një grua në një dyqan rrobash. Kjo është njëlloj sikur t'i thuash dikujt që po shuan një zjarr, mos e shuaj sepse t'i dikur ke pirë cigare.

Për ne që jetojmë në mes të zjarrit, nuk ka rëndësi as emri i zjarrfikësit dhe as marrëdhënia e tij me gratë. Ne duam që ai të shuajë zjarrin. Ne duam që Amerika të mbyllë luftërat, sepse nëse do vazhdonte edhe pak fëmijët tanë mund të shkonin ushtarë në frontin e Ukrainës apo në ndonjë front më afër. Për shkak të Ukrainës, Kosova kërcënohet seriozisht dhe yjet që dikur e përkrahnin këtë vend, përfshi Amerikën, kanë ndryshuar pozicionin ç'ka na rrezikon bashkarisht.

Ndryshe nga votuesit amerikanë në Texas apo në Pensilvania, ne jetojmë cdo ditë mbi thëngjinj sa herë kërcënohemi nga bomba atomike e Rusisë, nga inflacioni dhe nga dobësimi i pakthyeshem i Europës e cila nuk na pranon sepse është kaq e dobët.

Dobësimi i Evropës që shkëlqen në mes të reve, është një mundësi e madhe për Amerikën, për t'i mbyllur luftërat. Liderët e shëmtuar evropianë nuk kanë më fuqi të thonë jo. Prej kohësh ata i thonë Amerikës vetëm po. Edhe kur ajo lufton edhe kur ajo gabon edhe kur ajo pushton edhe kur ajo pushon.

Europianët i ngjajnë sot Këshillit që drejtonte Konstandinopijën kur ajo u pushtua nga turqit. Ata flasin për cilësinë e ujit ndërkohë që flota armike i bombardon nga deti. Liberalët flasin për transgender në kohë lufte, taman si ata priftërinjtë ortodoksë në Kostandinopojë që flasin për seksin e ëngjëjve dhe këtë e quajnë demokraci, pra një mundësi për të thënë çfarë të dua, kur të dua, sa herë dua.

Donald Trump nuk e kufizon këtë të drejtë, sepse ai thotë vetë çfarë të dojë, kur të dojë, sa herë të dojë dhe kjo është arsyeja që fitoi. Ai është produkt tipik i demokracisë kaotike prandaj kaosi i tij duket sikur nuk i shkon demokracisë. Gjatë mandatit të parë ai nuk mbylli asnjë gazetë, nuk burgosi asnjë kundërshtar, nuk nxorri asnjë parti jashtë ligjit dhe megjithëse nuk njohu zgjedhjet, e lëshoi zyrën dhe shkoi në shtëpi pa përdorur ushtrinë.

Ndryshimi që ai ka me shumë liberalë, është se ai mendon se demokracia nuk është një instrument i mjaftueshëm për të zgjidhur hallet e botës. Dhe ka shumë të drejtë.

Ai të pranon njëlloj edhe nëse je demokrat edhe nëse nuk je, mjafton të kesh diçka në dorë, pra të kesh fuqi. Nëse nuk i bindesh ai të kërcënon me tarifa në vend të bombave dhe kjo është demokratike. Ai i beson më shumë ekonomisë sesa luftës, më shumë dollarit sesa bombës atomike, më shumë sanksioneve sesa pushtimit.

Meqë kryesisht rreziqet vijnë nga Lindja, ai negocion në emër të Perëndimit për të shuar luftërat dhe për t'i futur armët në depo. A duhet t'i kërkojmë atëherë, që në vend që të negociojmë me Putinin tërheqjen nga Ukraina ta pyesi pse ka anuluar një koncert të një grupi muzikor me emrin Pussy Riot?

Do ishte e tepërt. Do ishte si biseda e priftërinjve në Kostandinopojë. Ndoshta edhe më keq.

Prandaj sot të gjithë ata që besojnë se lufta është kërcëimi më i madh i demokracive tona, kanë shpresë se Amerika ka votuar për të mos shkuar në luftë.

Dhe për këtë ka zgjedhur Presidentin Donald Trump, i cili edhe nëse nuk e do demokracinë, nuk e shkatërron dot atë.

Kështuqë mirësevini ne botën e Donald Trump. Është një argëtim që nuk mbaron asnjëherë me luftë.

Shpresoj.

LUTFI DERVISHI

BURGU, E VETMJA RRUGË...

Disa adoleshentë shqiptarë arrestohen në Belgjike për grabitje banesash. Pjesa tjetër e grupit i shpëton policisë dhe kthehet në Shqipëri. Gjykata në Bruksel jep dënim me kusht. Ata kthehen në Tiranë për t'iu gjendur pranë shokëve. Bazuar mbi dosjen e autoriteteve belge, prokuroria e krimeve të rënda këtu shqyrtoi çështjen për pjesën tjetër të grupit që i kishte shpëtuar drejtësisë belge. Në sallën e gjyqit shohin se shokët e tyre (ushtarët) marrin dënime të rënda, minimumi: 7 vjet burg! Ligji! Imagjioni trajektoren që mori e ardhmja e këtyre të rinjve.

Eshtë rasti ku përgjigja e parë dhe e fundit për çdo lloj krimi apo shkelje është: burg, burg, burg.

Nga krimet më të vogla, si mospagimi i faturave të energjisë elektrike, deri tek krimet më të rënda të trafikut ndërkombëtar të drogës, duket sikur ligji shqiptar shpesh funksionon si një thikë prestigjatori - bëhet thikë kasapi për qytetarët e zakonshëm dhe kthehet në thikë gome ndaj kriminelëve të mëdhenj.

Para një jave në Fier gjykata dënoi një çift pensionistësh (73 vjeç) me 14 vjet burg për "shfrytëzim prostitucioni"! Dhe të mendosh që për çështjet e mëdha kjo shifër duket po aq e largët sa Maja Kilimanxharos!

Në Shqipëri ka disa rekorde të zeza sa i përket politikës së dënimit. Jemi vendi që kemi numrin më të lartë të kërkesave për arrest ndërkombëtar në Interpol. Dhe për çfarë krimesh shpallim kërkim ndërkombëtar?

Një shembull që ilustron absurdin: një qytetar shqiptar, u ekstradua nga Athina për mos-pagesën e një fature energjie elektrike prej 28 000 mijë lekësh. Shpenzimet që shteti shqiptar pagoi për sjelljen e tij për të kryer dënimin janë pesëfish më të larta se detyrimi i pashlyer i qytetarit. A ia vlen ky lloj shpenzimi për raste të



tilla?

Kjo politikë e egër e te drejtes penale ka çuar në një shifër të frikshme. Që nga viti 1991 kemi 380 000 qytetarë të dënuar me burg. 380 000 të dënuar! 380 000! Te kjo shifër nuk futen ata që janë dënuar me kusht apo me punë në komunitet. Sot një në katër persona është i dënuar me vendim burgim i formës së prerë!

Ky është rekord i zi i vendosur sa me ndihmën e ligjvënësit, aq edhe me ndihmën e drejtësisë. Eshtë absurde, por ende kemi nene të kodit penal që dënojnë nga gjobë deri në 10 vjet burg!

Ndërsa kur bëhet fjalë për drogën, absurdi kap maja të reja. Një adoleshent i huaj i kapur në kufi me katër gram hashash rrezikonte dënimin me pesë

deri në pesëmbëdhjetë vjet burg për "trafik ndërkombëtar," sepse "kështu është ligji". Por rasti në Sukth kur u kapen 700 kilogram kokainë u trajtua si "posedim i paligjshëm," me dënim maksimal prej katër vjetësh. Ligji!

Kjo situatë është skandaloze, e pakuptimë, thellësisht e padrejtë dhe e papranueshme!

Një tjetër rekord të zi që mban vendi është numri i të ndaluarve me masën e dënimit arrest me burg. Nëse në BE, masa e dënimit me burg është përjashtim, këtu është kthyer në normë. (Në burgjet shqiptare 62% janë në paraburgim dhe 38% vuajnë dënimin pas vendimit të Gjykatës. Ky është rekord botëror!

Duke marrë në konsideratë shifrat dhe situatat: Kodi i ri Penal nuk është

thjesht i dëshirueshëm, por i domosdoshëm.

Në vend që të përqendrohet në dënim te ashpër për çdo rast, drejtësia duhet të kalojë nga një qasje automatike: "burg për gjithçka" në një qasje "të diferencuar" dhe "proporcionale".

Duhet ndërhyrje në legjislacion që të mbrohen qytetarët e zakonshëm nga ndëshkimi i tepruar dhe të përqendrohen energjitë e sistemit të drejtësisë në ndëshkimin e atyre që kryejnë krime të rënda/ "krime intelektuale".

Një politikë e re penale duhet të përqendrohet në proporcionalitetin dhe alternativat ndaj burgimit, duke krijuar një sistem që jo vetëm dënon, por kryesisht parandalon dhe rehabiliton.

Penalizimi për shkelje administrative si mospagimi i faturave apo krimet e vogla të posedimit të drogës mund të shërbejnë si shembuj të qartë ku dënimin me burg mund të zëvendësohet me dënime të tjera të përshtatshme, si shërbimi në komunitet apo gjoba, duke kursyer energjitë e sistemit dhe fondet publike.

Qasja "burg, burg, burg" kriminalizon shoqërinë. Një Kod i ri Penal, bazuar në proporcionalitet dhe trajtimin e rasteve sipas rrezikshmërisë së tyre reale, do të kontribuonte që të bëheshim një vend ku drejtësia i përgjigjet krimin në mënyrë efektive, pa sakrifikuar qytetarët e zakonshëm dhe fondet publike.

POROSISNI BANNERIN PER BIZNESIN TUAJ

Jepini diapazonin tuaj

Te gjitha llojet

- PVC Banners
- Premium Roller Banners
- Pull Up Roller Banners
- Mesh Banners



Adresa e zyrave:
30 Avenons Road, London, E13 8HT

Na kontaktoni:
020 7018 7929
073 4066 5946



AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Dotech
website 

Akoma nuk jeni
regjistruar
në Google?

NA KONTAKONI

Adresa e zyrave
30 Avenons Road
London E13 8HT



Vendoseni
biznesin tuaj
ne rrjetin e
bizneseve ne UK

020 7018 7929  Mob: 073 4066 5946  078 5997 7545

AKOMA NUK KENI BUSINESS CARDS?

NA KONTAKTONI:

020 7018 7929

073 4066 5946

078 5997 7545



**PËR ÇDO KONSULTIM MUND TE VINI
NË ÇDO KOHË NË ZYRAT TONA
ADRESA E ZYRAVE: 30 AVENONS ROAD,
LONDON, E13 8HT**

BUSINESS CARDS ME QR CODE

ZGJIDHNI PROFESIONISTËT PËR SUKSESIN E KOMPANISË TUAJ



**NA GJENI
NA FACEBOOK
KERKO
THE ALBANIAN
MBI 1 000 000 NDJEKES**

VETON SURROI

PYETJE PËR PARTITË: SI DO TË NDIZET POÇI?

Kosova, e mësuar me termocentralet e ndërtuara në socializëm, është në pikën më kritike të marrjes së vendimeve për ardhmërinë e vet energjetike. Siç tregojnë analizat, nuk ekziston një zgjidhje, por një sërë sish dhe partitë që e duan pushtetin në zgjedhjet e shkurtit duhet të shpjegojnë se cilën zgjidhje do ta bëjnë, kur dhe si?

1.

Në momentin kur CHATGPT-së ia bëni një pyetje jo shumë të ndërlikuar – si të kalohet një fundjavë e bukur në Romë, cilat janë statistikat e FC Barcelona në ndeshjet kundër Realit në pesë vitet e fundit, si të përgatitet pitja pa yndyrë – aktivizohen serverët e mëdhenj në gjysmën tjetër të botës dhe në procesim e sipër të pyetjes, shpenzojnë energjinë elektrike të barasvlershme me ndezjen e një poçi elektrik për 20 minuta.

Kjo statistikë nuk është e nevojshme për kuriozitet, por sepse në këtë moment është shënimi që intereson tërë industrinë që po ndërtohet mbi inteligjencë artificiale (IA) dhe që duhet të interesojë votuesit kosovarë dhe partitë politike kosovare që ua kërkojnë votat këtyre qytetarëve në shkurt të vitit të ardhshëm.

Në shikim të parë, zhvillimi i IA dhe zgjedhjet kosovare nuk duket të kenë gjë të përbashkët, por ja edhe shpjegimi që i lidh. Në gjendjen në të cilën jemi sot, IA llogaritet se shpenzon 1 për qind të energjisë elektrike botërore. Zhvillimi marramendës i inteligjencës artificiale bën që makinat llogaritëse që përdoren dyfishojnë kërkesën për energji elektrike çdo 3 apo 4 muaj. Llogaritet që deri në fund të këtij dhjetëvjetëshi, me ritmin e tanishëm të zhvillimit, inteligjenca artificiale do të konsumojë rreth 8 për qind të energjisë elektrike në botë.

E kjo do të thotë se bota duhet të prodhojë tetë për qind më shumë energji elektrike në një periudhë kohore kur po ashtu duhet të bëjë dekarbonizimin e këtij prodhimi. Pra gjithnjë e më pak qymyr e djegie naftë dhe gjithnjë e më shumë panele solare dhe turbina ere, mbase edhe energji bërthamore. Mbase, duke marrë parasysh kërkesën e madhe, energji elektrike gjithnjë e më e shtrenjtë.



2.

Çka ka kjo të bëjë me votuesin kosovar? Ai mund t'ia bëjë pyetjen Chatgpt-së dhe të shpenzojë 20 minuta të një poçi elektrik apo të bëjë një analizë të thjeshtë me konstatimin bazik se përderisa e tërë bota po ndryshon, madje në mënyrë aq dramatike sa të ballafaqohet me sfidën e re energjetike që sjell inteligjenca artificiale, vendimi i fundit për zhvillimin e energjisë elektrike në vend ka qenë ai i Kuvendit të Krahinës Autonome Socialiste të Kosovës dikund kah mesi i viteve shtatëdhjetë të shekullit të kaluar e që kishte të bënte me ndërtimin e Kosovës B. Pra, për pesëdhjetë vjet, institucionet e Kosovës nuk kanë marrë ASNJË vendim për zhvillimin e energjisë elektrike; këtu nuk po mendoj për strategji afatmesme apo afatgjate, por për vendime konkrete që do të ndryshonin gjendjen prej asaj të para pesëdhjetë vjetëve. Kosova funksionon me 91 për qind të energjisë elektrike nga stabilimentet që u ndërtuan në socializëm.

Dhe, ndonëse ka pasur natyrisht arsye që Kosova nuk ka mundur të vendosë gjatë okupimit 1989-1999, institucionet e Kosovës së lirë, në shkallë të ndryshme nuk kanë ndërtuar ASNJË kapacitet të ri energjetik që do të ndryshonte gjendjen e krijuar pesëdhjetë

vjet më parë. E, nga çlirimi i Kosovës ka kaluar një çerek shekulli.

3.

Tash, këtu në vjeshtën e vitit 2024 takohen të gjitha rrëfimet për energjetikën. Bota do të kërkojë më shumë energji elektrike dhe ajo, për shkak të obligimeve globale e evropiane për dekarbonizimin, duhet të krijohet nga burime të ripërtëritshme. Kosova, duhet të llogarisë se energjia e saj do të vazhdojë të prodhohet nga Kosova A dhe B deri sa të shemben këto stabilimente, por vendimi për stabilimentet e reja nuk mund të shtyhet më dhe është dramatikisht-tash. Për më tepër, siç shpjegon Luan Shllaku në analizën e botuar nga “Rinvest”, “Çfarë miksi i energjisë na duhet?”, që të gjitha vendimet fillojnë me faktin se nuk do të ketë më investim në termocentralet e reja dhe se nuk ekziston një formë e vetme e gjenerimit të energjisë që do të bëjë ndryshimin e prodhimit të energjisë. Pra, përkundër faktit se tashmë panelet diellore dhe turbinat e erës kanë hyrë në Kosovë dhe se do të gjenerojnë një përqindje të energjisë, kjo përqindje do të mbetet e vogël dhe nuk do ta zëvendësojë thëngjillin. Kjo sjell opsionet e radhës, furnizimin e Kosovës me gaz natyror, qoftë në lidhjen TAP nga Azerbajxhani, qoftë me gazsjellësin “amerikan” të vendosur në Aleksandropolis të Greqisë që sjell

gazin deri në Shkup për të vazhduar për në Prishtinë.

Po ashtu janë dy opsione, të cilat mendoj se meritojnë më shumë vëmendje dhe përkrahje. Njëri, ai që për gjeneratat e reja është i panjohur, por që në vitet shtatëdhjetë ka ekzistuar, shndërrimi i thëngjillit në gaz sintetik. Ky është opsion tashmë i verifikuar me teknologji të avancuar në Dakotën Veriore të SHBA-së (e Kinë), dhe në kushte ideale në Kosovë do të mbulonte (si një tranzicion 20-vjeçar) nevojat e veta elektroenergjetike, duke zvogëluar në masë të dukshme ndotjen e ambientit nga Kosova A dhe B.

I dyti është bashkëinvestim me Republikën e Shqipërisë në kapacitetet hidroenergjetike të Shqipërisë. Kosova kështu do të arrinte të kishte në bilancin e vet një sasi bukur të madhe e të sigurt energjie elektrike nga burimet e ripërtëritshme (hidrike).

Në mendjen time, qeveria e ardhshme duhet të përgatitet që të kërkojë ndihmë - jo në formë asistence por në formë përgatitjeje për investim nga SHBA-ja e nga Shqipëria. Me SHBA-në, biseda do të duhej të përqendrohej në mënyrën se si të ndërtohet një ndërmarrje si ajo e Dakotës Veriore në fushat e thëngjillit në Kosovë, me teknologjinë më të avancuar. Me Shqipërinë, biseda do të duhej të

përqendrohej në një model investimi në hidroenergjii, sikur është bërë në kaskadat e Skavicës nga Qeveria norvegjeze.

Dakota dhe Skavica – po i përmend si modele – do t'i jepnin Kosovës siguri energjetike deri më 2050, duke zvogëluar dukshëm ndotjen dhe duke e përgatitur vendin për kalim në një gjendje të plotë dekarbonizimi.


4.

Çfarëdo vendimi që do të marrë Kosova për energjinë, duhet të bëhet në mënyrë urgjente nga Qeveria, e cila do të formohet pas zgjedhjeve të 9 shkurtit të vitit të ardhshëm. Ky do të jetë vendimi më strategjik zhvillimor që mund të marrë një qeveri dhe reperkusioni i vendimit (apo mosmarrjes së vendimit) është aq i madh sa në listën prej 1 deri në 10 të pyetjeve që do t'u bëhet partive nga ana e qytetarëve dhe medieve, vendimi për energjinë do të meritonte të ishte në tri vendet e para.

Qytetarët e mediet, në fushatën e cila tashmë po zhvillohet me të madhe e me drejtim bukur të gabuar fyerjesh e ligjërimesh të pavërteta, do të duhej t'u shtronin pyetjen themelore çdokujt që pretendon ta marrë pushtetin: çfarë do të jetë vendimi juaj për energji, kur do ta merrni dhe si?

NA KOTAKTONI

0 7947 785174



SHERBIME Te TONA

NDIME FIZIKE

Ne Jemi Krenare Qe Ju Sherbejme Me Ekipin Tona Profesional Multidisiplinor Te Perbera Na Eksperta

SHENDETI MENDOR

Klinika Medi-Park Clinic Esht Ketu Tju Ndhimuar Ne Perminesime e Cilesise Se Jetes Tuaj . Rikuperimi Esht i Mundur

BUKURI DHR ESTETIKE

Medi-Park Beauty Ofron trajtime Bukurie Tradicionale Dhe Moderne Esteritike per meshkujt Dhe Per Femrat

DIAGNOSTIKA

Ne kryjme Nje Game Te Gjere Testesh rUTINE Ne laboratorin Tone. Si Dhe tESTE te Specializuara Me partneret Tona te Cilet jan Laboratore Te Akreditura Nmare Ne UK



INFORMACIONE KONTAKTI

Ne kudesimi
Per Shendetin
Tuaj

HAPUR
7 DIT
NE
JAVE

Numer Telefon
020 8341 3185

E-mail Address
Info@mediparkclinic.uk

Aandresa Jone
573 Green lanes, Harringay, London
N8 0RL

Oraret Sherbimet
te Henen. Shtunen:- 9 am - 7 pm
Te Dielen : 11 am- 6 pm



CHECK-UP

MEDIPARK 2023

VETEM
£249

GP Consultation

BMI & Body Composition

Vital Checks

- BP
- Pulse
- Temperature
- Oxygene Saturation

Urinary Analysis

ECG

Full Blood Count

Liver Function Tests

Bilirubins, Alk Phos, AST, ALT, Gamma GT,
Total Protein, Albumin, Globulin

Kidney Function Tests

Urea & Electrolytes (Sodium + Potassium + Chloride)
Bicarbonate + Creatinine + eGFR

Fasting Glucose




Te gjitha e Ballkanit ne nji Market produktet

318-324 Kilburn High Road, London, NW6 2QN | Tel: 020 7372 1059





Dotech
website



**A JENI
REGJISTRUAR
NË GOOGLE?**

AKOMA NUK KENI NJË WEBSITE?

Ne mund t'iu ndihmojme edhe me:

-Business Cards

-Logos

-Banners

-Posters

-Flyers

-Video Marketing

Për çdo konsultim mund te vini në zyrat tona

CONTACT US

Tel:020 7018 7929 Mob: 073 4066 5946 Mob: 078 5997 7545

Adresa e zyrave: 30 Avenons Road, London E13 8HT